

# GJINIA, PËRFAQËSIMI DHE PARTITË E DJATHTA

**Aksesi i grave në partitë politike të krahut  
të djathtë në Shqipëri**



**WFD**



**UK Government**

Të gjitha të drejtat në këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

## GJINIA, PËRFAQËSIMI DHE PARTITË E DJATHTA

Aksesi i grave në partitë politike të krahut të djathtë në Shqipëri



Shtator 2022

**Autorët: Edlira Çepani & Raquel Hernandez Pena**

HYRJE	3
1. GRATË E PARTIVE TË DJATHTA TË CILAT KANË THYER “TAVANIN E QELQTË”	5
2. PERSPEKTIVA GJINORE E ORGANIZIMIT DHE E RREGULLOREVE TË BRENDSHME TË PARTIVE TË DJATHTA	13
2.1 Rregullat e brendshme dhe masat e veçanta	14
2.2 Strukturat e veçanta të partive politike	18
2.3 Planet strategjike të veçanta për rritjen e kapaciteteve dhe rekrutimin e grave brenda partisë	19
3. Aksesit i grave në partitë e spektrit të djathtë në Shqipëri – Partia Demokratike (PD) si rast studimor	20
3.1 Gjetjet: komponenti sasior – anketa	26
3.1.1 Cilësitë e grave anëtare të Partisë Demokratike pjesëmarrëse në anketim	27
3.1.2 Eksperienca e grave të PD-së në politikë dhe si pjesë e strukturave partiake	28
3.1.3 Sfidat e grave anëtare të Partisë Demokratike në politikë dhe brenda partisë	32
3.2 Gjetjet: komponenti cilësor – intervistat	34
Histori, sfida dhe rekomandime të grave anëtare të Partisë Demokratike	
KONKLUZIONE	38
REKOMANDIME	39
SHTOJCA 1: Metodologjia kërkimore	41
BIBLIOGRAFIA	41

## SHKURTIMET

<b>PD</b> – Partia Demokratike	<b>PK</b> – Partia Konservatore Shqiptare
<b>PR</b> – Partia Republikane	<b>PSHA</b> – Partia Shqiptare Atdheu
<b>PDIU</b> – Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	<b>PRDSH</b> – Partia e Reformave Demokratike Shqiptare
<b>UKD</b> – Unioni Kristian Demokrat	<b>PSKSH</b> – Partia Socialkristiane e Shqipërisë
<b>LDGSH</b> – Lidhja e Grave të Partisë Demokratike të Shqipërisë	<b>PASSH</b> – Partia Aleanca Socialiste Shqiptare
<b>PSD</b> – Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	<b>LZHK</b> – Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar
<b>PDR</b> – Partia Demokrate e Re	<b>PÇSH</b> – Partia e Çështjeve Shqiptare
<b>AD</b> – Partia Aleanca Demokratike	<b>APPD</b> – Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet
<b>PASH</b> – Partia Ardhmëria Shqiptare	<b>ASHE</b> – Aleanca Shqiptare Europiane
<b>PAA</b> – Partia Agrare Ambientaliste	<b>AP</b> – Aleanca Popullore
<b>PV</b> – I Pavarur	<b>BD</b> – Partia Bashkimi Demokrat
<b>PBDNJ</b> – Partia për të Drejtat e Njeriut	<b>MEGA</b> – Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
<b>LSI</b> – Lëvizja Socialiste për Integrim	<b>PKKA</b> – Partia Kombëtare Konservatore Albania
<b>PKD</b> – Partia Demokristiane e Shqipërisë	<b>PPSH</b> – Partia e Punës e Shqipërisë
<b>PBL</b> – Partia Bashkimi Liberal Demokrat	<b>PBKD</b> – Partia Balli Kombëtar Demokrat
<b>PDS</b> – Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	<b>PESH</b> – Partia Emigracioni Shqiptar
<b>PLL</b> – Partia Lëvizja e Legalitetit	<b>PBK</b> – Partia Balli Kombëtar
<b>PS</b> – Partia Socialiste	<b>PKSH</b> – Partia Komuniste e Shqipërisë
<b>PDK</b> – Partia Demokristiane e Shqipërisë	<b>AMIE</b> – Aleanca e Maqedonasve për Integrim European

## Legjenda e grafikëve:

- Figura 1:** A ka partia juaj politike një qëndrim zyrtar, manifest apo rregullore për sa vijon?
- Figura 2:** A mendoni se numri i grave në të gjitha strukturat e partisë suaj është i mjaftueshëm?
- Figura 3:** Cilat konsideroni si çështjet më sfiduese me të cilat përballet një grua e angazhuar në politikë? (mund të zgjidhni deri në 3 opsione)
- Figura 4:** Sipas jush, sa ndikim kanë sa më poshtë vijojnë në frenimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe partitë politike?

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave në vendimmarrje po rritet globalisht, por rritja e këtyre shifrave vjen kryesisht prej partive të majta. Nën-përfaqësimi i grave në partitë e krahut të djathtë vijon të mbetet një çështje pezull në politikë. Në zgjedhjet e fundit kombëtare në Mbretërinë e Bashkuar u zgjodh një numër rekord i grave, të cilat arritën në 34% të përfaqësuesve të Dhomës së Ulët të Parlamentit Britanik. Megjithatë shumica e grave deputete të zgjedhura ishin nga partitë e spektrit të majtë: Partia Laboriste përfaqësuar me shumicën e grave, me një numër rekord prej 104 deputetesh gra<sup>1</sup>, ndërsa Partia Konservatore me vetëm një të katërtën e deputeteve gra. Në Kongresin Amerikan, gratë përbëjnë 37.7% të Partisë Demokratike, ndërsa vetëm 8.8% nga Partia Republikane janë gra<sup>2</sup>. Në Gjermani, gratë përbëjnë 34.7% të anëtarëve të Parlamentit (Bundestag), me në krye Partinë e Gjelbërt me 58% të grave deputete, e cila është e lartë krahasuar me nivelin prej vetëm 23% gra përfaqësuese të Bashkimit Demokratik Kristian (CDU) në Bundestag<sup>3</sup>. Në Spanjë gratë përfaqësojnë 42% të Kongresit të Deputetëve, nga të cilat shumica janë zgjedhur nga Partia Punëtore Socialiste me 30,4% deputete gra, e ndjekur nga Partia Popullore me 22,29%<sup>4</sup>.

Situata është e ngjashme edhe në rastin e Shqipërisë, ku 50 nga 140 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë janë gra (35.7%), nga të cilat 64% vijnë nga partitë e majta – 29 PS, 2 LSI dhe 1 PSD<sup>5</sup> – ndërsa vetëm 36% vijnë nga e partitë e spektrit të djathtë, përkatësisht 18 gra deputete nga PD-Aleanca për Ndryshim (përfshirë këtu PR dhe PDIU referuar grupeve parlamentare). Ky fenomen përsëritet ndër partitë e djathta dhe dëshmon se përfaqësueset politike të grave të spektrit të djathtë hasin barriera domethënëse në politikë. Realiteti është se gratë në partitë e majta zakonisht janë përfaqësuar në një numër më të madh dhe janë prirur të jenë më aktive veçanërisht në lidhje me çështje sociale apo lëvizje feministe, ndërsa gratë në partitë e krahut të djathtë mbeten të nën-përfaqësuar dhe ndonjëherë konsiderohen si të veçuara nga këto lëvizje. Deri më tani, shumë nga studimet mbi përfaqësimin politik të grave janë fokusuar tek gratë në partitë dhe qeveritë me prirje të majtë, duke paraqitur një analizë të njëanshme të sfidave dhe mundësive për gratë në politikë. Pse partitë e djathta zgjedhin më pak gra? Cili është ndikimi i grave dhe përfshirja e tyre politike në partitë e spektrit të djathtë? Cili është statusi që gratë kanë në spektrin e djathtë? Cilat janë dinamikat gjinore në partitë e djathta?

Pjesa më e madhe e punimeve shkencore mbi “gratë në politikë” kanë patur në fokusin e tyre shpjegimin e nën-përfaqësimit të grave në politikë përmes ndërveprimit të barrierave strukturore dhe shoqërore, stereotipeve gjinore në procesin e rekrutimit, përzgjedhjes dhe qasjes në burimet e partive politike, kulturës politike të dominuar nga burrat, ose mungesës së modeleve të grave. Disa studime vendosin fokusin në numrin e ulët të grave në partitë e krahut të djathtë, mungesës së përfaqësimit dhe të modeleve, të cilat sjellin mungesë të besimit dhe ambicieve politike krahasuar kjo me gratë në partitë e spektrit të majtë<sup>6</sup>. Partitë politike të majta dominohen nga gra të cilat i përkasin grupeve të interesit, si organizatat feministe, organizatat rinore, lëvizjet shoqërore për të drejtat e njeriut dhe sindikatat<sup>7</sup>.

<sup>1</sup>Duncan, P., & Busby, M. (2019, December 13). UK elects record number of female MPs | General election 2019. The Guardian. Retrieved from <https://www.theguardian.com/politics/2019/dec/13/uk-elects-record-number-of-female-mps>

<sup>2</sup>Women Serving in the 117th Congress (2021-2023). (n.d.). Center for American Women and Politics. Retrieved from <https://cawp.rutgers.edu/facts/levels-office/congress/women-serving-117th-congress-2021-2023>

<sup>3</sup>Grundmann, M. (2021, October 2). Opinion: The Bundestag could use more women | Opinion. DW. Retrieved from <https://www.dw.com/en/opinion-the-bundestag-could-use-more-women/a-59374736>

<sup>4</sup>Congreso de los Diputados. Retrieved from: <https://www.congreso.es/busqueda-de-diputados>

<sup>5</sup>Manuali Mandatet parlamentare. (2021, September 10). Kuvendi. Retrieved from <https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/mandatet.pdf>

<sup>6</sup>Malliga Och and Shauna L. Shames (2018) The Right Women: Republican Party Activists, Candidates, and Legislators.

<sup>7</sup>Perry Bacon Jr. (2018) Why The Republican Party Elects So Few Women. FivethirtyEight. Politics. Retrieved from: <https://fivethirtyeight.com/features/why-the-republican-party-isnt-electing-more-women/>

Ky sfond i aktivizmit social për shumicën e grave në spektrin e majtë e bën më të lehtë krijimin e modeleve dhe furnizimin e këtyre partive me prurje të grave kandidate të cilat kanë një rrjet të tyrin dhe eksperiencë sektoriale. Modelet dhe historitë e suksesit ndihmojnë gratë duke i frymëzuar dhe rritur vetëbesimin, si edhe duke i movituar ato të marrin pozicione lidershipi. Më specifikisht, studime të ndryshme tregojnë se rrugëtimi drejt lidershipit për gratë nuk nis vetëm me suksesin akademik apo emërimin e tyre në pozicione pushteti, por gjithashtu edhe nga ndikimi i qenësishëm i modeleve shoqërore në jetën e tyre.

Vështirësia për gratë e krahut të djathtë që të zgjidhen në poste dhe të advokojnë për barazinë gjinore ose përfaqësim të barabartë gjinor<sup>8</sup>, lidhet edhe me mungesën e prirjes për strategji gjinore në partitë e krahut të djathtë del në pah në proceset e përzgjedhjes së kandidatëve – bazuar tek meritat individuale dhe jo tek barrierat strukturore<sup>9</sup>. Megjithatë, partitë e krahut të djathtë të cilat i kanë kushtuar vëmendje diversifikimit të partisë dhe kanë përqendruar përpjekjet e tyre në rritjen e përfaqësimit të grave, po rezultojnë edhe si partitë më konkurruese dhe më të suksesshme në proceset zgjedhore. Të dhënat tregojnë se partitë e krahut të djathtë të cilat adoptojnë një qasje barazie gjinore – çka do të thotë dhënia përparësi zgjedhjes së grave – kanë tërhequr në mënyrë më efektive jo vetëm më shumë gra brenda partisë, por edhe më shumë gra votuese<sup>10</sup>. Kjo do të thotë se partitë e krahut të djathtë që veprojnë si aktorë strategjikë partiakë, advokojnë taktika të rritjes së përfaqësimit të grave të ndërtuara mbi bazën e një ideologjie gjinore dhe kontekstit institucional brenda partiak, kanë shanse më të mëdha për të arritur më shumë gra votuese dhe për të fituar zgjedhjet. Për shembull, Partia Konservatore në Mbretërinë e Bashkuar ndërmori nismën "Women2win" si një iniciativë për rekrutimin e kandidateve gra dhe vajza dhe që ka në fokus mbështetjen e këtyre kandidateve për kapërcimin e barrierave specifike gjinore për kandidimin e tyre për poste të ndryshme politike.

Ky studim synon të vlerësojë pozitat dhe barrierat që hasin gratë dhe vajzat brenda partive politike të djathta në Shqipëri, të japë një pasqyrim përfshirës me shembuj nga partitë e djathta të vendeve të tjera, si dhe të japë rekomandime për hapat e mëtejshëm të nevojshëm për garantimin e barazisë gjinore në partitë politike në Shqipëri dhe forcimin e strukturave të tyre. Për të kuptuar aksesin e grave në partitë e djathta në Shqipëri dhe për të trajtuar çështje të veçanta që u përkasin grave të djathta, është shqyrtuar si rast studimor Partia Demokratike e Shqipërisë si partia e krahut të djathtë më e votuar në Kuvendin e Shqipërisë, duke u fokusuar në disa çështje si: (a) tendencat në rekrutim dhe promovim, (b) politikën dhe vlerat brenda partisë, dhe (c) roli dhe fuqia e forumit të grave brenda partisë për identifikimin e kufizimeve institucionale për gratë e krahut të djathtë në Shqipëri, sikurse vihen në pah në hulumtimin e mëposhtëm.

---

<sup>8</sup>Catherine Wineinger. (2020) How do right-wing women advocate for increased representation within parties that reject identity politics? LSE BPP. Retrieved from: <https://blogs.lse.ac.uk/politicsandpolicy/right-wing-women-as-strategic-party-actors/>

<sup>9</sup>Marija Taglaga and Katrine Beauregard (2020) The Merit of Party Institutions: Women's Descriptive Representation and Conservative Parties in Australia and the United Kingdom. *Journal of Women, Politics and Policy*. Retrieved from: <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/1554477X.2020.1701934>

<sup>10</sup>Rosie Campbell and Silvia Erzeel (2018). Exploring Gender Differences in Support for Rightist Parties: The Role of Party and Gender Ideology. *Political and gender*. Cambridge University Press. Retrieved from: <https://www.cambridge.org/core/journals/politics-and-gender/article/abs/exploring-gender-differences-in-support-for-rightist-parties-the-role-of-party-and-gender-ideology/E5FE0E62B60CCA02AEC2CBE28E8A9D68>

## 1. GRATË E PARTIVE TË DJATHTA TË CILAT KANË THYER "TAVANIN E QELQTË"

Ndërsa disbalanca gjinore në partitë e djathta tërheq vëmendjen, mungesa e promovimit të grave mund të konsiderohet si një nga shkaqet e mungesës së tyre në partitë e krahut të djathtë. Ekziston një marrëdhënie e ngushtë mes fuqisë së lidërshiptit dhe promovimit publik dhe kjo marrëdhënie shihet rregullisht në plan të parë tek përpjekjet për të stimuluar aspiratat e vajzave të reja për lidërshipt përmes pedagogjisë publike të modeleve që thyen "tavanin e qelqtë".<sup>11</sup> Në dritën e hulumtimeve të mëparshme<sup>12</sup>, të cilat tregojnë rëndësinë e modeleve dhe ndikimin e tyre tek hyrja e grave në politikë dhe pjesëmarrja në vendimmarrje, merr rëndësi të veçantë promovimi i modeleve të grave udhëheqëse në partitë e djathta.

Gratë udhëheqëse të cilat kanë arritur suksese në politikë, u vijnë në ndihmë grave të tjera duke u treguar atyre mundësitë dhe rrugëtimin drejt pushtetit. Studimet tregojnë se pikëpamjet e grave për lidërshiptin fillojnë të formësohen që herët në fëmijëri, duke nisur me vlerat që ato mësojnë, ekspozimin e tyre ndaj aftësisht për lidërshipt, si edhe praninë e modeleve pozitive të lidërshiptit. Për më tepër, besimi i tyre inkurajohet nga modelet pozitive dhe prania e liderëve të fortë përfaqësues. Për të rritur numrin e grave të krahut të djathtë në politikë në nivel kombëtar dhe lokal, është e rëndësishme të kuptohet fuqia e socializimit të lidërshiptit, modelimit të lidërshiptit dhe ndërtimit të besimit përmes modeleve.<sup>13</sup>

Në këtë kontekst, kemi identifikuar dhe përzgjedhur disa gra nga partitë e djathta në mbarë botën, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipërinë, Spanjën dhe Kroacinë, të cilat kanë thyer "tavanin e qelqtë" në politikë – i cili i referohet barrierave jomateriale brenda politikës të cilat janë pengesë për arritjen e pozicioneve të nivelit të lartë nga gratë. Për secilën nga gratë e identifikuara, ne do të ndajmë të dhëna mbi rrugëtimin e tyre drejt lidërshiptit politik dhe mbi trashëgiminë e tyre në skenën politike të gjashtë vendeve të sipërpërmendura.

### MBRETËRIA E BASHKUAR



#### THERESA MAY

Kryeministre e Mbretërisë së Bashkuar<sup>14</sup>

2016 - 2019

**Lindur më:** 1 Tetor 1956, Eastbourne, Mbretëria e Bashkuar.

**Përkatësia Politike:** Partia Konservatore e Mbretërisë së Bashkuar

**Arsimi & Kariera:** May mbaroi shkollën e mesme në zonat rurale të Oksfordshire, për t'u regjistruar më pas në Universitetin e Oksfordit ku edhe mori diplomën Bachelor në Gjeografi.

Ajo punoi për Bankën e Anglisë (Bank of England) dhe më tej për Shoqatën për Shërbimet e Kleringut të Pagesave (APACS), ku shërbeu si drejtuese e Njësisë së Çështjeve Evropiane dhe si këshilltare e lartë për çështjet ndërkombëtare.

<sup>11</sup>Michele Paule and Hannah Yelin (2021) don't want to be known for it': Girls, leadership role models and the problem of representation. European Journal of Cultural Studies. Retrieved from: <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/13675494211004595>

<sup>12</sup>Ioana M. Latu, Marianne Schmid Mast, Joris Lammers and Dario Bombari (2013) Successful female leaders empower women's behavior in leadership tasks. Journal of Experimental Social Psychology. Retrieved from: <https://www.ed.ac.uk/files/atoms/files/latu2013.pdf>

<sup>13</sup>KPMG (2015) Women's Leadership Study: Moving Women Forward into Leadership Roles. Retrieved from: <https://assets.kpmg/content/dam/kpmg/ph/pdf/ThoughtLeadershipPublications/KPMGWomensLeadershipStudy.pdf>

<sup>14</sup>Theresa May. Retrieved from: <https://www.gov.uk/government/history/past-prime-ministers/theresa-may>  
Theresa May. Britannica. World leader. Retrieved from: <https://www.britannica.com/biography/Theresa-May>

## Rrugëtimi Politik:

**1986** – Këshilltare në Minibashkinë e Mertonit në Londër, deri në 1994.

**1997** – Pas dy humbjeve si kandidate e Partisë Konservatore, May u zgjodh për të përfaqësuar Maidenhead në Dhomën e Ulët të Parlamentit Britanik.

**1999** – May mbajti disa role si anëtare e ‘Kabinetit Hije’, duke përfshirë: Sekretarin e Shtetit në hije për Arsimin dhe Punësimin (1999–2001), Sekretarin e Shtetit në hije për Transportin, Qeverisjen Lokale dhe Rajonet (2001–2002), Sekretar e Shtetit në hije për Familjen (2004–2005), Sekretarin e Shtetit në hije për Kulturën, Median dhe Sportin (2005), si edhe rolin e Drejtueses së Dhomës së Ulët në hije (2005–2009). Përveç kësaj, May u bë Kryetarja e parë femër e Partisë Konservatore (2002).

**2010** – Pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, May u emërua Sekretare e Brendshme dhe në fakt do të bëhej Sekretarja e Brendshme Konservatore më jetëgjatë. Përveç këtij roli, ajo shërbeu gjithashtu si Ministre për Gratë dhe Barazinë Gjinore gjatë periudhës 2010–2012.

**2016** – Ajo u zgjodh kryetare e Partisë Konservatore dhe u emërua Kryeministre.

**2017** – May u zgjodh Kryeministre e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Partisë Unioniste Demokratike të Irlandës së Veriut (DUP).

**2019** - Theresa May shërbeu si Kryeministre deri më 24 korrik 2019. Ajo u rizgjodh si deputete e Maidenhead-it në dhjetor 2019.

## Trashëgimia dhe aktet kryesore të Theresa May:



*Gruaja e dytë Kryeministre e Britanisë së Madhe, e cila u përball me kompleksitetin e negociimit përgjatë kohëve nga më të vështirat në historinë e Evropës.*

### Politikat e brendshme:

- » Akti i Fuqive Hetuese 2016, i cili krijoi Auditin e parë të Pabarazisë Racore në Mbretërinë e Bashkuar për zbulimin e pabarazive racore në shërbimet publike.
- » Shpallja e zgjerimit më të madh të shërbimeve të shëndetit mendor për brezin përmes Planit Afatgjatë të NHS.
- » Nisja e Planit 25-vjeçar të Mjedisit për të trajtuar çështje të tilla si mbetjet plastike.
- » Prezantoi Strategjinë Moderne Industriale për nxitjen e krijimit të vendeve të punës në të gjithë vendin, me punësimin në Mbretërinë e Bashkuar që arriti nivele rekord të larta.
- » Themeloi projektin Women2win me Anne Jenkin me qëllim mbështetjen e grave konservatore në fushata zgjedhore dhe rritjen e përfshirjes së tyre në jetën publike.

### Niveli Evropian / Ndërkombëtar:

- » Akti i Tërheqjes nga Bashkimi Evropian në 2017 dhe 2018. Administrata e saj çoi përpara negociatat me Bashkimin Evropian mbi kushtet e daljes së Mbretërisë së Bashkuara nga BE dhe marrëdhëniet e ardhshme.
- » Theresa May zyrtarisht angazhoi Mbretërinë e Bashkuar për arritjen e “neto zero” emetimeve deri në vitin 2050, duke e bërë Britaninë të parën ekonomi që e ndërmerret këtë.
- » Koordinoi reagimin kundër përdorimit të armëve kimike në Siri me mbështetjen unanime të Kabinetit dhe autorizimin e forcave të armatosura të Mbretërisë së Bashkuar për të ndërhyrë në Siri.
- » Pas sulmit të inteligjencës ruse kundrejt Dhomës së Ulët të Parlamentit Britanik, ajo garantoj dëbimin më të madh kolektiv të ndërmarrë ndonjëherë ndaj zyrave të inteligjencës ruse në botën mbarë.





## ANGELA MERKEL

Kancelare e Gjermanisë

2005 - 2021

*Kancelarja e parë grua që ka qeverisur ndonjëherë në Gjermani, posti i tretë më i gjatë me 16 vjet.*

**Lindur më:** 17 Korrik 1954, Hamburg, Gjermani

**Përkatësia Politike:** Unioni Kristian Demokrat (Christian Democratic Union, CDU)

**Edukimi dhe Karriera:** Merkel mbaroi (1973) shkollën e mesme në Templin të Gjermanisë Lindore dhe mori (1978) diplomën Bachelor në Fizikë në Universitetin Karl Marks (tani Universiteti i Leipzig).

Më pas ajo punoi në Institutin Qendror të Kimisë Fizike të Akademisë së Shkencave në Berlinin Lindor, duke fituar (1986) Doktoraturën me tezën e saj mbi Kiminë Kuantike.

### Rrugëtimi Politik:

**1989** – U bashkua me partinë "Fillimi Demokratik" (Demokratischer Aufbruch, DA) dhe shërbeu si zëvendës-zëdhënëse e Qeverisë së Gjermanisë Lindore.

**1990** – Në zgjedhjet federale gjermane të vitit 1990, Merkel dhe DA iu bashkuan CDU-së dhe ajo garoi me sukses në zgjedhjet për Bundestag-un si përfaqësuese e zonës elektorale parlamentare Stralsund-Nordvorpommern-Rügen në veri të Mecklenburg-Vorpommern.

**1991** – Kancelari Helmut Kohl do ta emëronte papritur Angela Merkel si Ministre për Gratë dhe Rininë. Ajo ishte zgjedhur më parë në Bundestag si përfaqësuese e zonës së saj zgjedhore Stralsund-Rügen-Grimmen në shtetin Mecklenburg-Pomerania Perëndimore – sikurse edhe ka vijuar të zgjidhet për çdo zgjedhje që atëherë.

**1994** – Pas fitores së CDU/CSU, Angela Merkel vijoi angazhimin e saj si Ministre për Gratë dhe Rininë deri në vitin 1994, për t'u emëruar më tej si Ministre e Mjedisit.

**1998** – Ajo u emërua Sekretare e Përgjithshme e CDU-së pas humbjes së partisë së saj në zgjedhjet federale.

**2000** – U bë Kryetare partie e CDU-së.

**2002** – Ajo ishte kryetare e grupit CDU/CSU në Bundestag.

**2005** – Teksa fitoi zgjedhjet dhe formoi një aleancë të partive CDU/CSU dhe SPD, njohur tradicionalisht në Gjermani si "koalicioni i madh", Bundestagu zgjodhi Angela Merkelin si kancelaren e parë grua në historinë e Gjermanisë.

**2008** – Fillimi i krizës së madhe financiare në Evropë e gjeti Merkelin duke luajtur një rol të madh kundrejt fondit të shpëtimit për Euron dhe marrjes së masave stabilizuese.

**2009** – Ajo u rizgjodh Kancelare në një koalicion të CDU/CSU me FDP.

**2011** – Pas katastrofës së Fukushimës, ajo njoftoi përshkallëzimin e mbylljes së centraleve bërthamore në Gjermani.

**2013** – Rizgjedhja për herë të tretë si Kancelare në koalicionin e dytë të madh midis CDU/CSU dhe SPD në historinë e Gjermanisë.

**2014** – I bëri thirrje Evropës dhe botës për solidaritet në përgjigje ndaj krizës së refugjatëve sirianë.

**2018** – Mandati i katërt si Kancelare në koalicionin e tretë të madh.

**2018** – Tërhiqet nga posti i Kryetares së CDU-së dhe njofton vendimin për të mos kandiduar për postin e kancelares në zgjedhjet e ardhshme.

**2020** – Qeveria e Merkelit zgjodhi të mbështesë me vendosmëri një plan Evropian të përbashkët veprimi kundër pandemisë së virusit Corona.

**2021** – U dorëhoq nga posti i Kancelares gjermane.

## Trashëgimia e Angela Merkelit<sup>15</sup> dhe vendimet e saj me impakt të gjerë<sup>16</sup>



*Pozicioni i saj ka qenë simbolikisht i rëndësishëm për përfaqësimin e grave, duke luajtur një rol kyç në emërimin e grave në pozicione kyçe.*

### Politikat e brendshme:

- » Prezantoi mekanizmin kushtetues të frenimit të borxhit (Schuldenbremse) duke garantuar buxhete të balancuara.
- » Nënshkroi rezolutën për heqjen dorë nga energjia bërthamore.
- » Mori vendimin për të anashkaluar rregullat e BE-së për azilkërkuesit dhe për të hapur kufijtë e Gjermanisë për më shumë se një milion refugjatë nga Siria dhe vende të tjera.
- » Në lidhje me përfaqësimin e grave:



Anëtarë Kabineti të CDU  
**Kabineti Merkel 1**



Anëtarë Kabineti të CDU  
**Kabineti Merkel 2**



Anëtarë Kabineti të CDU  
**Kabineti Merkel 3**



Anëtarë Kabineti të CDU  
**Kabineti Merkel 4**

### Në nivelin e Bashkimit Evropian:

- » Udhëhoqi zbatimin e masave shtrënguese dhe reformave strukturore gjatë krizës së borxhit të Eurozonës. Liderhipi i saj i fortë në garantimin e qëndrueshmërisë së Eurozonës kontribuoi për një Bashkim Ekonomik dhe Monetar më të gjerë dhe më të fortë.
- » Mbështeti detyrimet e BE-së në luftën kundër krizës së virusit Corona dhe planin e rimëkëmbjes për Evropën.

## SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS



### CONDOLEEZZA RICE

Sekretare e Shtetit<sup>17</sup>  
2005 - 2009

*Gruaja e dytë dhe e para grua afrikano-amerikane që mban postin e Sekretares së Shtetit.*

**Lindur më:** 14 nëntor 1954, në Birmingham, Alabama, SHBA

**Përkatësia Politike:** Partia Republikane

**Edukimi dhe Karriera:** Condoleezza Rice mori diplomën Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare në 1974. Më tej ajo mori diplomën Master (1975) në Ekonomi nga Universiteti i Notre Dame dhe Doktoraturën (1981) në Studime Ndërkombëtare nga Universiteti i Denverit, ku fusha e saj e specializimit ishte Evropa Lindore dhe Qendrore dhe Bashkimi Sovjetik, duke përfshirë çështjet ushtarake dhe ato të sigurisë.

<sup>15</sup>Angela Merkel. Britannica. World Leaders. Retrieved from: <https://www.britannica.com/topic/Christian-Democratic-Union-political-party-Germany> Deutschland.de (2021) Angela Merkel – her political career in pictures. Retrieved from: <https://www.deutschland.de/en/topic/politics/angela-merkel-governs-germany-16-years-as-chancellor>

<sup>16</sup>Matthias Matthijs (2021) Merkel's Legacy and the Future of Germany Retrieved from: <https://www.cfr.org/in-brief/merkels-legacy-and-future-germany>

<sup>17</sup>Office of the Historian, Foreign Service Institute United States Department of State. Biographies of the Secretaries of State: Condoleezza Rice (1954–) Retrieved from: <https://history.state.gov/departmenthistory/people/rice-condoleezza>

Stanford University. Condoleezza Rice. Department of Political Science. Retrieved from: <https://politicalscience.stanford.edu/people/condoleezza-rice>

## Rrugëtimi Politik:

**1989** - Shërbeu në administratën e Presidentit Bush si drejtore e çështjeve sovjetike dhe të Evropës lindore në Këshillin e Sigurisë Kombëtare.

**1987** – Shërbeu si këshilltare e Shefit të Shtabit të Përbashkët për strategjinë bërthamore.

**1991** – U bë këshilltare për politikën e jashtme në fushatën presidenciale të George W. Bush.

**2001** – Shërbeu si Asistente e Presidentit George W. Bush për çështjet e Sigurisë Kombëtare (Këshilltare për Sigurinë Kombëtare) duke u bërë gruaja e parë që mbajti këtë post.

**2005** – U bë e para grua afrikano-amerikane që shërben si Sekretare e Shtetit të SHBA-ve.

**2009** – Largohet nga posti i Sekretares së Shtetit.

### Trashëgimia dhe ndikimi i Condoleezza Rice në diplomacinë e SHBA-ve:



*Revolucionarizoi shërbimin e jashtëm amerikan përmes reformimit të institucionit përmes mbështetjes së zgjerimit të qeverive demokratike dhe avancimit të idesë së rishpërndarjes së diplomatëve amerikanë në zona me probleme të rënda sociale dhe politike, duke adresuar çështje të tilla si sëmudnjë, kontrabandën e drogës dhe trafikimin e qenieve njerëzore, si edhe duke rivënë theksin tek ndihma e jashtme.*

Rice ishte Sekretarja e parë e Shtetit që vizitoi Libinë në më shumë se 50 vjet. Ajo trajtoi një sërë çështjesh të reja, kryesisht në kuadër ndërmarrjes së iniciativës së gjerë të administratës Bush për përhapjen e demokracisë, një përpjekje kjo me fokus të veçantë shtetet e moderuara arabe të Lindjes së Mesme. Luajti një rol kyç në negociimin e disa marrëveshjeve në Lindjen e Mesme, përfshirë:

- » Ndihamoi në rivendosjen e marrëdhënieve midis Izraelit dhe Palestinës për të adresuar çështjet thelbësore, si kufijtë, refugjatët dhe statusin e Jeruzalemit. U arrit progres me hapjen e kufirit të Gazës në 2005, armëpushimin midis Izraelit dhe forcave të Hezbollahut në Liban në 2006 dhe organizimin e Konferencës së Annapolis-it në 2007 e cila u fokusua në gjetjen e një zgjidhjeje me formulën “dy shtete” për problemin izraelito-palestinez.
- » Kontribuoi në përmirësimin e të drejtave të njeriut në Iran dhe mbështeti miratimin e një Rezolutive të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për vendosjen e sanksioneve kundrejt Iranit në rast të moskufizimit të programit të tij të pasurimit të uranimit.

Përveç kësaj, Rice udhëhoqi dialogun dhe luftën kundër programit bërthamor të Koresë së Veriut. Ajo negocioi nënshkrimin e suksesshëm të Marrëveshjes SHBA–Indi për Bashkëpunim në lidhje me Përdorimet Paqësore të Energjisë Bërthamore (Marrëveshja 123), e cila do të mundësonte tregtinë civile bërthamore midis të dyja vendeve.

## SPANJA



### ESPERANZA AGUIRRE

Kryebashkiake e Madridit

2003 - 2012

*Gruaja e parë që u bë Kryetare e Bashkisë së Madridit dhe Presidente e Senatit.<sup>18</sup>*

**Lindur më:** 3 Janar 1952, Madrid, Spanjë

**Përkatësia Politike:** Partia Popullore

<sup>18</sup>TeleMadrid. Esperanza Aguirre, una vida dedicada a la política. Retrieved from: <https://www.telemadrid.es/noticias/madrid/Esperanza-Aguirre-vida-dedicada-politica-0-1392760728--20120917025137.html>

**Edukimi dhe Karriera:** Esperanza Aguirre mori diplomën Bachelor në Drejtësi (1974) në Universitetin Complutense të Madridit. Ajo fitoi një pozicion si nëpunëse civile në Korporatën e Informacionit dhe Teknikëve të Turizmit në vitin 1976 dhe u bë drejtuese e Shërbimit të Reklamimit të Turizmit. Nga viti 1979 deri në vitin 1982 ka mbajtur poste të ndryshme në Ministrinë e Kulturës: drejtuese e Zyrës Teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Librit dhe Kinematografisë (1979), zëvendës-Drejtoreshë e Përgjithshme e Studimeve në Sekretariatit e Përgjithshëm Teknik (1980), zëvendës- Drejtoreshë e Përgjithshme e Zyrës Teknike të Nënsekretarit të Kulturës (1981) dhe zëvendës-Drejtoreshë e Përgjithshme e Fondacioneve dhe Shoqatave Kulturore (1982).

### **Rrugëtimi Politik:**

**1983** – Filloi me përfshirjen e saj në politikë në vitet gjashtëdhjetë, kur ajo iu bashkua Unionit Liberal dhe u bë kryetare e Unionit në komunitetin e Madridit deri në vitin 1986. Në po të njëjtin vit, ajo u zgjodh këshilltare në Bashkisë së Madridit si përfaqësuese e Koalicionit Popullor (AP- PDP-UL).

**1987** – Ajo jep dorëheqjen nga Unioni Liberal dhe i bashkohet Aleancës Popullore, e cila më vonë do të rithemelohej si Partia Popullore në vitin 1989. Përveç kësaj, ajo u rizgjodh si këshilltare në Bashkinë e Madridit dhe u bë zëdhënëse e Njesisë Villaverde. Gjithashtu ajo do të emërohej si zëdhënëse për Sportin dhe Transportin Publik në Bashkinë e Madridit.

**1989** – Partia Popullore dhe CDS qeverisin Madridin për herë të parë që nga rivendosja e zgjedhjeve vendore konkurruese në vitin 1979. Ajo emërohet shefe e Departamentit të Mjedisit e Bashkisë.

**1993** – U bë këshilltare për Mjedisin, Arsimin, Kulturën dhe Sportin dhe vijimësisht në vitin 1995 u bë zëdhënëse bashkiake e PP-së dhe Nën-kryetarja e parë e Bashkisë së Madridit.

**1996** – U bë anëtare e Senatit dhe u emërua Ministre e Arsimit dhe Kulturës nga kryeministri i sapozgjedhur Jose Maria Aznar; përveç kësaj, Esperanza Aguirre u bë pjesë e Komitetit Ekzekutiv Kombëtar të Partisë Popullore.

**1999** – Aguirre do të zëvendësohej në postin e saj si Ministre e Arsimit dhe Kulturës, porse do të bëhej gruaja e parë në historinë e Spanjës e cila mbajti postin e Presidentes së Senatit.

**2002** – Jep dorëheqjen nga posti i Presidentes së Senatit për të kandiduar për Bashkinë e Madridit.

**2003** – PP dhe Esperanza Aguirre fituan zgjedhjet e ripërsëritura dhe ajo do të bëhej gruaja e parë Presidente e Komunitetit të Madridit (Kryetare e Bashkisë së Madridit) ku edhe shërbeu për gati nëntë vjet deri në vitin 2012.

**2004** – Aguirre u zgjodh Kryetare e Partisë Popullore në Madrid deri në vitin 2011.

**2012** – Tërhiqet nga politika për shkak të problemeve shëndetësore.

### **Esperanza Aguirre, 42 vjet përkushtim në politikë:**



#### ***Model frymëzues i grave udhëheqëse në tranzicionin spanjoll drejt demokracisë***

- » Ndërmori reformën e kurrikulës së arsimit të mesëm të detyrueshëm dhe asaj universitare, duke fuqizuar studimet në fushën e shkencave humane.
- » Përmirësoi qasjen në shërbimet shëndetësore duke reduktuar kohën e pritjes për operacionet.
- » Ndërtoi tetë spitale të reja.
- » Ndërtoi 87 shkolla të reja shtetërore (shumica e tyre dygjuhëshe).
- » Rriti investimet për bursa të ndryshme në arsim.
- » Zgjeroi transportin nëntokësor duke përfshirë zona periferike si Pozuelo de Alarcón.



## KOLINDA GRABAR-KITAROVIC

*Presidente e Republikës*

2015 - 2020

*Gruaja e parë që u zgjodh Presidente e Republikës që nga zgjedhjet e para shumëpartiake të vitit 1990 dhe pavarësia nga Jugosllavia në vitin 1991.*

**Lindur më:** 29 Prill 1968, Rijeka, Kroaci

**Përkatësia politike:** Bashkimi Demokratik Kroat (Croatian Democratic Union)

**Arsimi & Karriera:** Kolinda Grabar-Kitarović<sup>19</sup> ndoqi shkollën fillore në Rijeka në Kroaci dhe mbaroi shkollën e mesme në Los Alamos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo mori diplomën Bachelor në Anglisht dhe Spanjisht nga Fakulteti Filozofik pranë Universitetit të Zagrebit, si dhe përfundoi arsimin e mëtejshëm në gjuhën portugeze. Ka kryer Akademinë Diplomatike të Vjenës. Në vitin 2000 ajo mori titullin Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Fakulteti i Shkencave Politike pranë Universitetit të Zagrebit. Nga viti 2002 deri në 2003, si studiuese e programit Fulbright ajo kreu kërkime para-doktorale në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Politikat e Sigurisë pranë Universitetit George Washington në ShBA.

### Rrugëtimi Politik:

**1992** – Këshilltare pranë departamentit të bashkëpunimit ndërkombëtar në Ministrinë e Shkencës dhe Teknologjisë.

**1993** – I bashkohet zyrtarisht Bashkimit Demokratik Kroat.

**1995** – U bë këshilltare pranë departamentit të Amerikës së Veriut në Ministrisë së Jashtme.

**1997** – Emërohet si Këshilltare pranë Ambasadës Kroate në Kanada dhe në vijim Ministër-Këshilltare dhe Zëvendës-Shefe e Misionit.

**2000** – Me ardhjen në pushtet të Partisë Socialdemokrate, Kolinda Grabar-Kitarović përvijoi ndjekjen e studimeve diplomatike si studiuese e programit Fulbright, duke fokusuar kërkimet para-doktorale në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikave të sigurisë në Universitetin George Washington në ShBA.

**2003** – U zgjodh deputete dhe u emërua Ministre e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian deri në vitin 2008.

**2008** – U bë ambasadore e Republikës së Kroacisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

**2011** – U emërua Ndhmës Sekretare e Përgjithshme e NATO-s për Diplomacinë Publike deri në vitin 2014.

**2015** – Kolinda Grabar-Kitarović u zgjodh Presidente e Kroacisë deri në vitin 2020.

### Trashëgimia e Kolinda Grabar-Kitarović në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në Kroaci.<sup>20</sup>



*Një grua që theu "tavanin e qelqtë" për marrëdhëniet dhe sigurinë ndërkombëtare.*

- » Ajo ka thyer shumë "tavane të qelqta" duke shërbyer si gruaja e parë e emëruar si Ndhmës Sekretare e Përgjithshme e NATO-s për Diplomacinë Publike, si Ministre e Punëve të Jashtme dhe si Ambasadore në SHBA.

<sup>19</sup>Council women World Leader. Biography: Kolinda Grabar-Kitarović.. Retrieved from: <https://www.councilwomenworldleaders.org/kolinda-grabar-kitarovic263.html>

Office of the President of the Republic of Croatia. Kolinda Grabar-Kitarović. Retrieved from: <https://www.predsjednik.hr/en/bivsi-predsjednici/kolinda-grabar-kitarovic/>

<sup>20</sup>Outgoing President Proud of Croatia's Achievements During Her Term Retrieved from: <https://www.total-croatia-news.com/politics/41315-outgoing-president>

- » Udhëhoqi Kroacinë në rrugën drejt integritimeve euro-atlantike dhe ishte Kryetare e Delegacionit Shtetëror për Negociatat për anëtarësimin e Republikës së Kroacisë në Bashkimin Evropian.
- » Iniciativa “Tre Detet” (Three Seas), e cila bashkoi 12 vende anëtare të BE-së me qëllim kapërcimin e disbalancave të brendshme përmes heqjes së ndarjeve artificiale mes shteteve anëtare të vjetra dhe të reja dhe konsolidimin e Evropës si treg dhe territor.
- » Nënshkroi Marrëveshjen e Parisit në selinë e OKB-së në New York City.

## SHQIPËRIA



### JOZEFINA TOPALLI

Kryetare e Parlamentit

2005 - 2013

*Gruaja e parë që u bë Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë (2005–2013) dhe Nën-kryetare e Partisë Demokratike të Shqipërisë.*

**Lindur më:** 26 nëntor 1963, Shkodër, Shqipëri

**Përkatësia Politike:** Partia Demokratike e Shqipërisë

**Edukimi & Karriera:** Jozefina Çoba Topalli është diplomuar në Universitetin Luigj Gurakuqi në Shkodër duke përfunduar studimet e dyfishta në Matematikë dhe Drejtësi. Më pas ajo studioi për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Padovës në Itali dhe mori një diplomën Master për Administrim Publik dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Tiranës. Në vitin 2010, ajo mori doktoraturën e saj në Universitetin e Tiranës, me disertacionin me temë “Roli i Kuvendit Kombëtar në Procesin e Integritimit Evropian të vendit”. Nga viti 1992 deri në vitin 1995 ajo punoi pranë Dhomës së Tregtisë në qytetin e Shkodrës dhe në vitet 1995–1996 ka qenë kancelare dhe pedagoge në Universitetin Luigj Gurakuqi të Shkodrës. Topalli është anëtare e Legjislaturës Kombëtare që nga viti 1996. Në vitin 2005, Topalli u zgjodh Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe e mbajti postin e saj deri në vitin 2009.

#### Rrugëtimi Politik:

**1996** – Topalli u zgjodh deputete e Partisë Demokratike të Shqipërisë në Shkodër në zgjedhjet parlamentare të vitit 1996, për t’u rizgjedhur më pas gjashtë herë radhazi. Ajo ka qenë anëtare e Komisionit për Çështjet Sociale, Shëndetësinë dhe Familjen, si dhe zëvendëskryetare e Komisionit të Fëmijëve.

**1996** – Nga viti 1996 deri në vitin 2013, Topalli ka qenë deputete e Partisë Demokratike të Shqipërisë për qytetin e Shkodrës.

**1997** – Nga viti 1997 deri në vitin 2013, Topalli ka qenë Nën-kryetare e Partisë Demokratike të Shqipërisë.

**2005** – Topalli bëhet Kryetarja e parë grua e Kuvendit të Shqipërisë në të gjithë historinë parlamentare të vendit dhe Kryetarja e gjashtë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në historinë pluraliste parlamentare që nga viti 1991.

**2009** – Zonja Topalli u rizgjodh Kryetare e Kuvendit për mandatin e dytë.

**2020** – Pas përjashtimit nga Partia Demokratike në 2017, së bashku me një grup të rinjsh, themelon Partinë “Lëvizja për Ndryshim” me të cilën kandidon në zgjedhjet e vitit 2021. Partia nuk arrin të kalojë pragun e përcaktuar dhe nuk arrin të fitojë përfaqësim në Kuvend.

**2022** – Nëpërmjet procesit të zgjedhjeve dhe reformimit të Partisë Demokratike në vitin 2022, zonja Topalli rikthehet në PD dhe zgjidhet anëtare e Kryesisë së Partisë Demokratike.



- Zonja Topalli është fokusuar në drejtim të forcimit dhe promovimit të Diplomacisë Parlamentare. Në kuadër të diplomacisë parlamentare, një risi e sjellë në jetën politike shqiptare nga Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë,
- » Jozefina Topalli u angazhua në përshpejtimin e ratifikimit nga parlamentet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, si edhe të protokolleve të NATO-s për anëtarësimin e Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut.
  - » Në vitin 2013, si deputete e opozitës, zonja Topalli drejtoi nismën ligjore të dekriminalizimit në Kuvendin e Shqipërisë.

## 2. PERSPEKTIVA GJINORE PËR RREGULLAT & RREGULLORET E BRENDSHME E PARTIVE TË DJATHTA

Për të bërë përpara me pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në partitë e spektrit të djathtë, hapi i parë do të ishte analizimi i rregullave të brendshme partiake. Rregullat dhe rregulloret e brendshme të partive politike duhet të sigurojnë organizimin e brendshëm dhe transparencën e duhur në vendimmarrje, duke ndihmuar në përcaktimin e funksionimit të partisë, roleve të anëtarëve dhe strukturave së saj. Përveç kësaj, këto rregulla të brendshme janë gjithashtu tregues i përpjekjeve të partisë politike për të tërhequr gratë dhe për të promovuar një mjedis politik që mundëson pjesëmarrje dhe rol udhëheqës të barabartë brenda partisë<sup>21</sup>.

Në këtë kontekst, një këndvështrim krahasues i rregullave të brendshme të partive të djathta ka për qëllim të ofrojë një platformë dialogu, të zbulojë ngjashmëritë dhe dallimet të cilat mund të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë zhvillimin e partive politike të krahut të djathtë dhe akteve të tyre rregullatore të cilat reflektojnë ndjeshmëri gjinore. Analiza fokusohet në hartëzimin e partive të krahut të djathtë në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, SHBA, Shqipëri, Spanjë dhe Kroaci, duke hedhur vështrimin mbi<sup>22</sup>:

**Rregullat e brendshme dhe masat e veçanta.** Adresimi i barazisë gjinore në kuadrin ligjor të partisë, jo vetëm mundëson integrimin në vizionin e partisë, por gjithashtu dhe kombinimin e

- ✓ rregullave për arritjen e këtij vizioni. Të tilla rregulla dhe masa të veçanta përfshihen me qëllim përcaktimin e një niveli minimal përfaqësimi dhe për t'u siguruar që një numër i caktuar grash të përfshihen në strukturën dhe organet e brendshme partiake.

**Strukturat e veçanta të partive politike.** Organizatat e grave të partive politike si struktura të brendshme partiake të cilat synojnë forcimin e përfaqësimit të grave brenda partisë dhe në jetën politike në përgjithësi. Krijimi i organizatave të grave ndihmon në fuqizimin e tyre brenda partisë në

- ✓ dy dimensione të ndryshme, përkatësisht (1) duke rritur përfaqësimin e grave dhe vazave në nominimet partiake, dhe (2) duke amplifikuar zërin e grave në proceset vendimmarrëse, përmes një përqindjeje të caktuar të delegateve me të drejtë vote në nivelet e ndryshme të strukturës partiake.

**Planet strategjike të veçanta për rekrutimin e grave brenda partisë.** Ofrimi i programeve të

- ✓ trajnimit dhe aftësimit mbi tema të veçanta që lidhen me fushatat dhe të cilat janë në dobi të drejtpërdrejtë të kandidatëve gra dhe vajza.

<sup>21</sup>NDI (2017) Political parties' internal rules from a gender perspective: Comparatives Experiences. Retrieved from: <https://nimd.org/wp-content/uploads/2017/10/Political-parties%E2%80%99-internal-rules-from-a-gender-perspective-Comparatives-Experiences-NIMD-and-IDEA.pdf>

<sup>22</sup>IKNOWPOLITICS. Best Practices Used by Political Parties to Promote Women in Politics. Retrieved from: [https://iknowpolitics.org/sites/default/files/cr\\_best\\_practices\\_used\\_by\\_political\\_parties\\_to\\_promote\\_women\\_in\\_politics.pdf](https://iknowpolitics.org/sites/default/files/cr_best_practices_used_by_political_parties_to_promote_women_in_politics.pdf)

Në përgjithësi, partitë e krahut të djathtë duket se i përqendrojnë përpjekjet e tyre në sigurimin e një strukture/platforme të pavarur për forumet e grave, e cila ka për qëllim të identifikojë, trajtojë dhe mentorojë gratë të cilat kandidojnë për poste. Duke patur parasysh argumentin se partitë e krahut të djathtë preferojnë të rekrutojnë kandidatët në bazë të meritave të tyre dhe jo gjinisë, përdorimi i masave të veçanta është mjaft i pazakontë brenda këtyre partive. Megjithatë, ka përjashtime, si p.sh. Unioni Kristian Demokrat (CDU) në Gjermani. Ky rast lidhet kryesisht me (1) sistemin ligjor dhe federalizmin në Gjermani, të cilët ndikojnë fuqishëm tek partitë dhe proceset e tyre të përzgjedhjes së kandidatëve, si edhe (2) me presionin në rritje të publikut lidhur me përgjegjësinë e partisë sa i përket përfaqësimit të grave. Për rrjedhojë, CDU i ka përmbushur këto kërkesa duke futur së fundmi një "politikë të qartë të barazisë gjinore" brenda partisë, e cila synon të garantojë rrugëtimin politik të grave brenda partisë përmes vendosjes së kuotave gjinore në të gjitha nivelet dhe refuzimit të listave të kandidatëve që nuk e respektojnë këtë kuotë.

Pavarësisht mungesës së masave të posaçme, është e rëndësishme të theksohet se partitë e djathta të marra në vëzhgim në këtë studim, e kanë si vlerë thelbësore parimin e barazisë midis grave dhe burrave referuar aspekteve që lidhen me performancën e institucioneve, siç mund të vërehen në kodet e etikës, statutet apo qasjet ideologjike. *Për shembull:*

*"Partia Popullore do të sigurojë mundësi të barabarta punësimi për të gjithë anëtarët e saj për të garantuar:*

*(i) Mosdiskriminimin mbi çfarëdolloj baze, si origjina, raca, seksi, feja, opinionet, ose gjendja e veçantë fizike apo sociale, me qëllim kultivimin dhe promovimin e diversitetit të anëtarëve të Partisë.*

*(ii) Theks i veçantë i kushtohet barazisë midis burrave dhe grave."*

**Kodi i Etikës dhe Sjelljes, Partia Popullore, Spanjë.**



## Rregullat e brendshme të partive politike dhe masat e veçanta



### Britania

#### Partia Konservatore

*Kodi i Sjelljes*<sup>24</sup>: Ky kod përfshin standardet minimale të sjelljes brenda partisë dhe fokusohet tek garantimi i mosdiskriminimit apo ngacmimit bazuar në moshën, paaftësinë, ndryshimin e gjinisë, martesën dhe partneritetin civil, shtatzëninë dhe amësinë, racën, fenë ose besimin, seksin dhe orientimin seksual (Pjesa 1, seksioni 1). Ky seksion përfshihet në Aktin e Barazisë 2010.

*Kushtetuta*<sup>25</sup>: Në seksionin mbi bordin, ai përfshin detyrimin e organizatës (Neni 17.13) për të garantuar përfshirjen dhe përfaqësimin e duhur të grave në të gjitha aspektet e punës dhe organizimit të partisë, duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, mbështetjen e një organizate për promovimin e interesave të grave brenda Partisë.

*E njëjta ide përsëritet në Asosacionin në nivel lokal me nxitjen e krijimit të komiteteve të posaçme, duke përfshirë edhe Komitetin e Gruas.*

<sup>24</sup>Conservatives (2022) Code of Conduct for Members and Representatives of the Conservative Party. Retrieved from: <https://www.conservatives.com/code-of-conduct>

<sup>25</sup>Conservatives. Constitution of the Conservative Party. Retrieved from: <https://public.conservatives.com/organisation-department/202101/Conservative%20Party%20Constitution%20as%20amended%20January%202021.pdf>



*Rregullat për përzgjedhjen në Partinë Konservatore*<sup>26</sup>: Sipas rregullores së brendshme për përzgjedhjen e kandidatëve, shoqatat vendore (Komiteti i Filtrimit) do të kenë formuar një komision të filtrimit të përbërë nga kryetari i shoqatës, dy nënkryetarë të shoqatës, dy anëtarë të tjerë të shoqatës, si edhe të paktën një grua dhe një person nën moshën 30 vjeç.

Përveç kësaj, diskriminimi pozitiv përmendet referuar përzgjedhjes së aplikanteve gra gjatë procesit të përzgjedhjes.

*Politika e shanseve të barabarta*<sup>27</sup>: Në funksion të garantimit të mundësive të barabarta brenda partisë (anëtarë, zyrtarë dhe punonjës), kjo politikë ka për synim arritjen e barazisë dhe vendosjen e procedurave për heqjen e çdo diskriminimi të mundshëm. Kjo politikë specifikon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, viktimizimin dhe ngacmimin.

## Gjermania

Unioni  
Kristian  
Demokrat

*Kodi i Vlerave*<sup>28</sup>: Kodi përfshin konceptin e barazisë gjinore si pjesë të vlerave thelbësore. Për më tepër, ai i referohet "rolit aktual për barazinë" të luajtur nga gratë dhe burrat dhe kontributit të tyre për CDU-në dhe shoqërinë në tërësi.

*Statuti Kombëtar*<sup>29</sup>: Parashikon masa të veçanta për t'u siguruar grave qasje të barabartë në vendimmarrjen brenda partisë. Këto masa përfshijnë:

- ✓ *Integrimin e parimeve të barazisë mes anëtarëve gra dhe burra si vlerë thelbësore e partisë, me një vëmendje dhe prioritet të veçantë kushtuar pjesëmarrjes së grave në Nenin 15, i cili përcakton se gratë duhet të mbajnë poste partiake në CDU dhe të përfshihen në mënyrë të barabartë në mbajtjen e mandateve publike.*
- ✓ *Vendosjen e kuotës së grave në të gjitha nivelet e strukturës partiake në nivelet 40-50%, varësisht peshës që zënë gratë në raport me deputetët e Asamblesë Kombëtare.*
- ✓ *Konceptin e refuzimit, që u jep organeve zgjedhore të drejtën për të refuzuar propozimet e kandidatëve nëse ato nuk kanë nominime të mjaftueshme të grave.*

## Kroacia

Unioni  
Demokratik  
Kroat

Aktet nënligjore të Unionit Demokratik Kroat parashikojnë kuotën gjinore prej 30% në të gjitha nivelet e strukturës partiake.

<sup>26</sup>Conservative (2018) Rules for the selection of Conservative Party Candidates in Target and Conservative held seats in England, Wales and Northern Ireland for the UK Parliament. Retrieved from: [https://www.wealdenconservatives.com/sites/www.wealdenconservatives.com/files/2019-01/Rules %20for%20the%20Selection %20of%20Candidates.pdf](https://www.wealdenconservatives.com/sites/www.wealdenconservatives.com/files/2019-01/Rules%20for%20the%20Selection%20of%20Candidates.pdf)

<sup>27</sup>Conservative (2021) Equality Opportunities policy. Retrieved from: <https://www.conservatives.com/equal-opportunities-policy>

<sup>28</sup>CDU. (2022) Grundwertecharta. Antrag des Bundesvorstandes an den 35. Parteitag der CDU Deutschlands Retrieved from: <https://assets.ctfassets.net/nwwnl7ifahow/1HEdtjRCAN8Shf1ihdkYco/bc2b167d0a79037131078d1538eb61bf/CDU-Grundwertecharta.pdf>

<sup>29</sup>CDU. Änderung des Statuts und weiterer satzungrechtlicher Bestimmungen. Anträge des Bundesvorstandes an den 35. Parteitag der CDU Deutschlands Retrieved from: [https://assets.ctfassets.net/nwwnl7ifahow/3j2rZMoSOrcj969avGu4X/8a0a1febee18b2bc418eac32e2777e85/B\\_Aenderungen\\_des\\_Statuts\\_der\\_GO\\_der\\_FBO\\_und\\_der\\_PGO\\_\\_Antraege\\_des\\_Bundesvorstandes\\_\\_inkl.\\_B61\\_bis\\_B63.pdf](https://assets.ctfassets.net/nwwnl7ifahow/3j2rZMoSOrcj969avGu4X/8a0a1febee18b2bc418eac32e2777e85/B_Aenderungen_des_Statuts_der_GO_der_FBO_und_der_PGO__Antraege_des_Bundesvorstandes__inkl._B61_bis_B63.pdf)

*Rregullat e Partisë Republikane*<sup>30</sup>:

Janë përfshirë masa specifike me qëllim sigurimin e një numri të barabartë të grave dhe burrave në strukturat e partisë Republikane:

- ✓ Anëtarët e Komitetit Kombëtar Republikan do të përbëhen nga një (1) anëtar dhe një (1) anëtare e komitetit kombëtar. (Rregulli nr.1)
- ✓ Zyrtarët e Komitetit Kombëtar Republikan: tetë (8) nënkryetarët do të përfshijnë nga një (1) burrë dhe një (1) grua. (Rregulli nr.5)
- Komiteti Ekzekutiv i Komitetit Kombëtar Republikan: 11 anëtarë, nga të cilët tetë (8) prej tyre duhet të përbëhen nga një (1) burrë dhe një (1) grua të zgjedhur nga dhe prej secilit prej katër (4) grupeve rajonale. (Rregulli nr.6)
- ✓ Komisioni i Përhershëm i Buxhetit: i përbërë nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, tre (3) prej të cilëve emërohen nga kryetari i Komitetit Kombëtar Republikan, dhe secili nga katër (4) rajonet zgjedh dy (2) anëtarë, përkatësisht një (1) burrë dhe një (1) grua, në grupin e vet rajonal. (Rregulli nr.10)
- ✓ Platforma, Kredencialet, Rregullat dhe Rendi i Ditës, si dhe Organizimi i Përhershëm i Konventës duhet të kenë në përbërje nga një (1) burrë dhe një (1) grua për çdo komitet. (Rregulli nr.41)
- ✓ Çdo shtet do të përpiqet të ketë një përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave në delegacionin e tij në Konventën Kombëtare Republikane. (Rregulli nr. 1)

Masat specifike në lidhje me vendimmarrjen:

- ✓ *Votimi:* Në konventë, delegacionet dhe pozicionet individuale (duke përfshirë përfaqësuesin burrë dhe përfaqësuesen grua në komitetin kombëtar, ose kryetarin e cilitdo shtet) nuk do të kenë të drejtë për t'u votuar në më shumë se një (1) pozicion si delegat dhe nuk do të kenë të drejtë për më shumë sesa një (1) votë.

*Kodi i Etikës dhe Sjelljes*<sup>31</sup>: Përfshirja e parimit të barazisë lidhet jo vetëm për garantimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat që aderojnë në parti, por gjithashtu lidhet edhe me dinjitetin njerëzor dhe parandalimin e dhunës, abuzimit dhe çdo lloj sjelljeje tjetër që mund të dëmtojë dinjitetin e çdo anëtari.

*Statuti Kombëtar*<sup>32</sup>: Si pjesë e vlerave të partisë (Neni 4), e drejta e barazisë dhe lirisë mes grave dhe burrave përmendet si një vlerë thelbësore e partisë, e cila është gjithashtu në përputhje me të drejtat kushtetuese spanjolle.

<sup>30</sup>The rules of the Republican Party: As adopted by the 2020 Republican National Convention August 24, 2020. Retrieved from: [https://prod-stat-ic.gop.com/media/Rules\\_Of\\_The\\_Republican\\_Party.pdf?\\_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223](https://prod-stat-ic.gop.com/media/Rules_Of_The_Republican_Party.pdf?_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223)

<sup>31</sup>Partido Popular. Código Etico y de Conducta. Retrieved from: [https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/codigo\\_etico\\_pdf.pdf](https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/codigo_etico_pdf.pdf)

<sup>32</sup>Partido Popular. Estatutos Nacionales. Retrieved from: [https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/estatutos\\_definitivos.pdf](https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/estatutos_definitivos.pdf)

Njëkohësisht statuti thekson kompromisin e partisë për promovimin e pajtueshmërisë familje-punë mes grave dhe burrave. (Preambula)  
Referenca të tjera të konceptit të barazisë mund të gjinden përgjatë statutit, ndonëse ato nuk lidhen me barazinë gjinore.

*Rregullore*<sup>33</sup>: Zbatimi praktik i kuotave gjinore nuk gjendet në rregulloret e brendshme të partisë.

## Shqipëria

### Partia Demokratike

*Statuti i Partisë Demokratike ka dispozita të ndryshme për garantimin e barazisë gjinore brenda strukturave të partisë:*

- ✓ *Integrimi i parimeve të barazisë dhe mundësive të barabarta, si dhe gjithëpërfshirjes së anëtarësisë, si vlera thelbësore dhe prioritet për të drejtat e njeriut (Neni 2).*
- ✓ *Në rubrikën e objektivave të partisë, përmendet respektimi i barazisë gjinore, ndërsa i kushtohet vëmendje e veçantë pjesëmarrjes së gruas në strukturat vendimmarrëse dhe ato ekzekutive të partisë (Neni 3).*
- ✓ *Kuota gjinore 30% në çdo strukturë partiake (Neni 9).*
- ✓ *Kuotë gjinore 30% në strukturat e zgjedhura vendimmarrëse të partisë si Këshilli Kombëtar dhe Kryesia e Partisë (Neni 44 & Neni 47).*

*Si pjesë e strukturave ekzekutive brenda Partisë, aktet nënligjore parashikojnë edhe një Sekretariat për Organizatat Partnere, të cilat janë Organizata e Gruas (LDGSH) dhe Organizata Rinore (FRPD) e partisë, i cili mbulon edhe çështjet e barazisë gjinore.*

*Partia gjithashtu ka hartuar një Program dhe Plan Veprimi për Barazinë Gjinore në vitin 2021.*

Përveç kësaj, shumica e partive të djathta të përzgjedhura në këtë studim, me përjashtim të Spanjës dhe Kroacisë, kanë një strukturë të brendshme për gratë – sikurse Organizata e Grave – e cila fokusohet në inkurajimin e aktivitetit politik dhe përfshirjes së grave dhe vajzave brenda partisë. Nëse ndalemi për të kuptuar dhe identifikuar strukturën e cila ofron më mirë fuqi reale për grupimin e grave brenda partive të djathta, ne do të veçonim Komitetin Kombëtar të Gruas në SHBA. Partia Republikane jo vetëm ka vendosur një sistem i cili synon të balancojë përfaqësimin e grave dhe burrave brenda strukturave partiake, me një anëtare të komitetit kombëtar grua dhe një anëtar burrë, por gjithashtu ka caktuar një kuotë për elitën partiake, të tillë që mund të kontrollojë dhe përcaktojë vendimmarrjen e saj. Sistemi i votimit brenda Partisë Republikane ndihmon në garantimin e një niveli të ekuilibrit gjinor të pushtetit midis anëtarëve gra dhe burra.

Partitë e krahut të djathtë të përzgjedhura nga skena politike në Spanjë<sup>34</sup> dhe Kroaci<sup>35</sup> nuk kanë një strukturë formale të grave brenda partisë. Në vend të kësaj, këto parti kanë krijuar një entitet të veçantë organizativ që synon të ndikojë në politikën kombëtare për çështje të ndryshme, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore, familjen, fuqizimin ekonomik të grave, etj. Bie në sy që, ndonëse këto struktura nuk kanë një status ligjor brenda partisë, organigrama e tyre përfshin gra anëtare të partisë dhe axhenda politike e këtyre strukturave ndërlidhet me aktivitetet partiake.

<sup>33</sup>Partido popular. Reglamentos. Retrieved from: <https://transparencia.pp.es/normativas/>

<sup>34</sup>Mujeres e Igualdad. Retrieved from: [http://www.mujeresenigualdad.com/Mesa-Feminismo-Liberal\\_es\\_1\\_4142.html](http://www.mujeresenigualdad.com/Mesa-Feminismo-Liberal_es_1_4142.html)

<sup>35</sup>HDZ. Zajednica žena "Katarina Zrinski". Retrieved from: <https://moj.hdz.hr/mi-smo/ustrojstvo/zajednica-zena-katarina-zrinski>

## 2.2 Special structures of the political parties



### Britania

#### Partia Konservatore

Organizata e Grave Konservatore (Conservative Women's Organisation, CWO) punon për gratë anëtare të Partisë Konservatore dhe për përfaqësimin e pikëpamjeve të tyre tek Lideri i Partisë, Kryetari dhe deputetët. CWO ofron mundësi trajnimi, mentorimi dhe të folurit në publik. Ajo mbështet gratë të cilat dëshirojnë të përfshihen në të gjitha nivelet e jetës publike dhe në komunitetet e tyre lokale.

Komiteti i Grave – shoqata e formës së komitetit lokal brenda partisë.

### Gjermania

#### Unioni Kristian Demokrat

Unioni i Grave i Unionit Demokristian të Gjermanisë (FU) është një strukturë brenda partisë CDU e cila synon të llojë për interesat e grave brenda partisë.

### SHBA

#### Partia Republikane

Komiteti Kombëtar i Grave (National Committeewoman)<sup>36</sup> është një strukturë e grave brenda Komitetit Kombëtar Republikan, e përbërë nga anëtare gra të partisë Republikane.

### Spanja

#### Partia Popullore

37

### Kroacia

#### Unioni Demokratik Kroat

38

### Shqipëria

#### Partia Demokratike

LDGSH<sup>39</sup> - e themeluar më 18 gusht 1991 si një organizatë vullnetare e grave shqiptare bazuar në parimet dhe vlerat e demokracisë liberale në Shqipëri. LDGSH synon të promovojë pjesëmarrjen e grave në politikëbërje dhe vendimmarrje në kuadër të funksioneve politike në Partinë Demokratike të Shqipërisë.

<sup>36</sup>The rules of the Republican Party: As adopted by the 2020 Republican National Convention August 24, 2020. Retrieved from: [https://prod-stat-ic.gop.com/media/Rules\\_Of\\_The\\_Republican\\_Party.pdf?\\_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223](https://prod-stat-ic.gop.com/media/Rules_Of_The_Republican_Party.pdf?_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223)

<sup>37</sup> & <sup>38</sup> Based on the research and materials available the People's Party in Spain and the Croatian Democratic Union do not have official structures of women.

<sup>39</sup>Partia Demokratike. Lidhja e Gruas. Retrieved from: <https://pd.al/lidhja-e-gruas/>

Për sa i përket rekrutimit të grave brenda partisë, mes partive të spektrit të djathtë të përzgjedhura në këtë studim vërehen tre procese të ndryshme rekrutimi: rekrutimi i drejtpërdrejtë, rekrutimi i tërthortë dhe rekrutimi i kombinuar.

**Rekrutimi i drejtpërdrejtë** bëhet kur partia ka një rol aktiv në identifikimin dhe furnizimin me prurje përmes krijimit të programeve apo iniciativave specifike për gratë dhe vajzat. Programe të tilla synojnë krijimin e një hapësire brenda partisë e cila ka në fokus të saj dëgjimin e grave dhe gjithashtu mbështetjen e hyrjes së tyre në politikë. Shembulli më i mirë i këtij lloji të rekrutimit vjen nga Partia Konservatore në Britaninë e Madhe, e cila spikat me iniciativën “Women2win” brenda partisë, e cila ka për qëllim rritjen e numrit të grave në parlament dhe në jetën publike.

**Rekrutimi i tërthortë** u referohet atyre partive të djathta të cilat nuk kanë një projekt të brendshëm zyrtar, por që prurjet e grave në parti të tyre vijnë prej organizatave me ideologji dhe axhenda të ngjashme. Spanja dhe Kroacia përfaqësojnë këtë lloj të rekrutimit nga jashtë partisë, duke u përqëndruar tek ngritja e çështjeve dhe dhe krijimi i një axhende të grave që kontribuon në politikën dhe programet e partisë. Kjo lloj strategjie ngrihet mbi bazën e një filozofie të meritës individuale përkundër barrierave strukturore. Shqipëria mund të kategorizohet në grupin e vendeve që aplikojnë rekrutimin e tërthortë.

Lloji i fundit përfaqëson kështu **rekrutimin e kombinuar** në të cilën krahas projektit të saj, partia gjithashtu përdor kanale të tjera të ndryshme rekrutimi përmes partneritetit me organizata të tjera me ideologji të ngjashme. Partia Republikane në SHBA do të ishte një shembull i kësaj forme rekrutimi. Partia ka bërë përpjekje domethënëse për përfshirjen e një projekti të veçantë për gratë brenda partisë, duke forcuar në të njëjtën kohë edhe marrëdhëniet me organizata të tilla si “Maggie's List” për të rritur numrin e grave konservatore në politikën amerikane.

## 2.3 Strategji dhe programe të veçanta për rekrutimin dhe ngritjen e kapaciteteve të grave brenda partisë



### Britania

Partia  
Konservatore

Projekti Women2win është një iniciativë të krijuar në vitin 2005 që vazhdon ende dhe që ka në fokus mentorimin e grave konservatore dhe mbështetjen e tyre gjatë fushatave elektorale. Për më tepër, Women2win shihet si një grup presioni brenda Partisë Konservatore që ka sjellë më shumë gra konservatore në skenën politike dhe në Dhomën e Ulët të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar.

### Gjermania

Unioni  
Kristian  
Demokrat

‘Gratë mbështesin Gratë’<sup>41</sup> është një program mentorimi që synon t’u ofrojë anëtareve grad he vajza të CDU-së mbështetje dhe këshilla të personalizuar për futjen e tyre në politikë dhe gjithashtu akses në trajnime, rrjetëzim dhe forume diskutimi.

### SHBA

Partia  
Republikane

Projekti ‘Rritja e Mundësive Republikane për Gratë’ (GROW)<sup>42</sup> ishte një nismë e ndërmarrë nga Komiteti Kombëtar Republikan, i cila synonte prurje të më shumë grave të talentuara në parti. Strategjia e nismës GROW u fokusua tek rekrutimi dhe trajnimi.

<sup>40</sup>Maggies List. Retrieved from: <http://maggieslist.org/about>

<sup>41</sup>Fraue Union. Bericht zur politischen Gleichstellung von Frauen und Männern Retrieved from: <https://www.frauenunion.de/sites/www.frauenunion.de/files/artikelimages/220121-34pt-gleichstellungsbericht.pdf>

<sup>42</sup>Mallig Och. (2017) assessing efforts to make the republican party more woman-friendly. Retrieved from: <https://scholars.org/contribution/assessing-efforts-make-republican-party-more-woman-friendly>

Spanja

Partia  
Popullore

Kroacia

Unioni  
Demokratik  
Kroat

Shqipëria

Partia  
Demokratike

LDGSH ka zbatuar disa nisma për ngritje kapacitetesh dhe ndërgjegjësimin, por jo si pjesë e një programi dhe strategjie të strukturuar afatgjatë të partisë. Në vitin 2021, LDGSH hartoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të Partisë Demokratike.

### 3. QASJA E GRAVE NË PARTITË E DJATHTA NË SHQIPËRI: Partia Demokratike si Rast Studimor

Partitë parlamentare të krahut të djathtë në Shqipëri përfshijnë Partinë Demokratike, e cila është Partia e dytë më e madhe në vend, dhe partitë më të vogla, si Partia Republikane dhe Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Në Shqipëri, pjesëmarrja e grave në politikë dhe në pozicione vendimmarrëse ka ardhur duke u rritur vit pas viti, veçanërisht si rezultat i punës dhe presionit nga lëvizjet për të drejtat e grave. Po kështu është shënuar gjithashtu një tendencë në rritje e pjesëmarrjes së grave në Kuvend sa i përket partive të spektrit të djathtë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 4.6% e deputetëve të djathtë ishin gra (2 nga 45), specifikisht Jozefina Topalli dhe Marjeta Zaçe Pronjari. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005, vetëm 5.4% e deputetëve (3 nga 56) të Partisë Demokratike dhe vetëm 10% deputetëve (1 nga 11) të Partisë Republikane ishin gra. Konkretisht, Jozefina Topalli, e cila u bë kryetare e Kuvendit, Arenca Trashani dhe Majlinda Bregu të cilat u bënë anëtare nga Partia Demokratike kabinetit nga Partia Demokratike, dhe Lajla Pernaska nga Partia Republikane.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, për shkak të futjes në ligjin zgjedhor të kuotës 30% për përfaqësimin e grave, 14.5% e deputetëve (10 nga 69) nga Partia Demokratike dhe zero nga Partia Republikane (e cila fitoi vetëm një mandat) ishin gra. Me një përfaqësim më të gjerë në Grupin Parlamentar të PD-së dhe me deputete të zëshme në Kuvend për çështjet e barazisë gjinore, si Lajla Pernaska, Mesila Doda dhe Albana Vokshi, pati një theks dhe fokus më të madh në avokimin e barazisë gjinore dhe çështjeve të grave brenda partisë dhe në Kuvend.

Ndërkohë në zgjedhjet vijuese parlamentare, numri i grave të Partisë Demokratike të përfaqësuar në Kuvend shënoi një trend në rritje. Kështu, në vitin 2013 kishte 17.5% deputete gra (10 nga 57), në vitin 2017 ishin 25.6% deputete gra (11 nga 43) dhe në vitin 2021 kishte 30.5% deputete gra (18 nga 59).



Aktualisht në Kuvendin e Shqipërisë janë 50 gra të zgjedhura nga 140 deputetë gjithsej – nga të cilat 36% (18 nga 50) janë përfaqësuese të Partisë Demokratike dhe partive të tjera të djathta, ndërsa 64% (32 nga 50) janë përfaqësuese të partive të majta. Kjo do të thotë, siç u përmend edhe më herët në këtë studim, se në Shqipëri ashtu si dhe në vende të tjera të botës, ekziston një hendek i konsiderueshëm në përfaqësimin e grave në politikë kur bëhet fjalë për partitë e djathta dhe të majta.


Edhe pse të pakta në numër, gratë deputete nga partitë e djathta kanë qenë shumë aktive në lëvizjet për barazi gjinore dhe vendimmarrje. Kështu ato kanë dhënë kontributin e tyre në rithemelimin e Aleancës së Grave Deputete<sup>43</sup> në vitin 2008, si edhe drejtimin e saj prej disa vitesh, përkatësisht nga Mesila Doda (2009–2013), Dhurata Çupi (2013–2021) dhe Merita Bakiu (aktualisht). Aleanca e Grave Deputete është një strukturë joformale ndërpartiake e grave deputete në Kuvendin e Shqipërisë. Në kuadër të Aleancës, gratë deputete punojnë së bashku dhe kanë arritur objektiva të përbashkëta për fuqizimin e grave në politikë, vendimmarrje dhe fusha të tjera të jetës shoqërore. Ato kanë shënuar këto arritje përmes nismave ligjore dhe të tjera nismave të përbashkëta. Ato dhanë një ndihmë vendimtare në mbështetje të nismës së shoqërisë civile për futjen në ligjin zgjedhor të kuotës gjinore 50% për përfaqësimin në Këshillat Vendore dhe rishikimin e Kodit Zgjedhor në funksion të një përfaqësimi më të mirë të grave në listat e kandidatëve gjatë viteve të fundit.

Sa i përket përfaqësimit të grave në qeveri, që nga viti 2000, Partia Demokratike në koalicion me parti të tjera më të vogla ka udhëhequr qeverinë për 2 mandate (2005–2009 dhe 2009–2013) gjatë të cilëve kanë mbajtur poste ministrore 2 gra, znj. Arenca Trashani (2005–2009) dhe znj. Majlinda Bregu (2009–2013). Në mungesë të rregullimit me kuota gjinore, numri i grave kandidate për kryetare bashkie në nivel vendor ka qenë historikisht shumë i ulët, pavarësisht kahut të partive politike (të spektrit të majtë apo të djathtë). Pas futjes së parashikimit ligjor të kuotës gjinore prej 50% në listat e kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe refuzimit të listave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në rast të mosrespektimit të kësaj kuote, numri i grave kandidate dhe këshilltare vendore është rritur në mënyrë eksponenciale për të gjitha partitë politike. Ndërsa për postet për kryetar bashkie për të cilat nuk parashikohen kuota të përcaktuara me ligj, numri vijon të mbetet ende shumë i ulët.

Nga një pikëpamje krahasuese e kandidatëve dhe fituesve në zgjedhjet parlamentare dhe lokale nga viti 2001 në vitin 2021, vihet re se në pjesën më të madhe të rasteve, partitë e majta në Shqipëri kanë tendencën të kandidojnë më shumë gra dhe vajza, çka rezulton në një numër më të lartë të grave dhe vajzave të zgjedhura nga radhët e tyre.


Zgjedhjet Parlamentare 2001

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	93	3	43	2
PS	87	10	67	7
PSD	91	6	4	0
PDR	76	4	6	0
AD	89	6	3	0
PASH/ PAA	82	5	3	0
PBDNJ	83	10	3	0
I Pavarur	36	3	2	0



Zgjedhjet Parlamentare 2005

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	94	4	53	3
PS	90	8	38	4
LSI	92	8	5	0
PR	94	4	10	1
PSD	89	18	5	2
PDR	91	8	4	0
PAA	90	6	4	0
AD	83	7	3	0
PBDNJ	82	2	2	0
PDK	41	4	2	0
PDSSH	95	5	2	0
BLD	88	12	1	0
I Pavarur	9	2	1	0




<sup>43</sup>The Alliance of Women MPs is a voluntary organization of women legislators of all groups and political parties in the Parliament of Albania. The women's caucus in the Albanian parliament was first established in 1995 and was re-established in 2008 <https://www.parliament.al/Kuvendi/AleancaGraDeputete>


### Zgjedhjet Parlamentare 2009

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	105	39	59	10
PS	109	34	52	13
LSI	98	42	4	0
PR	104	37	1	0
PBDNJ	60	41	1	0

**669** Kandidate  
**5** Parti Parlamentare



Gra Kandidate




Gra të Zgjedhura


### Zgjedhjet Parlamentare 2013

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	106	44	47	10
PS	115	38	50	15
LSI	92	48	13	3
PDIU	86	51	4	0
PR	171	81	3	0
PKD	90	42	1	0
PBDNJ	76	43	1	0

**1083** Kandidate  
**7** Parti Parlamentare



Gra Kandidate




Gra të Zgjedhura


### Zgjedhjet Parlamentare 2017

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	153	41	32	11
PS	104	52	53	21
LSI	87	59	15	4
PDIU	81	63	2	1
PKD	89	54	1	1

**783** Kandidate  
**5** Parti Parlamentare



Gra Kandidate




Gra të Zgjedhura


### Zgjedhjet Parlamentare 2021

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD/ AN	102	51	41	18
PS	94	59	46	28
LSI	92	61	2	2
PSD	90	63	2	1

**612** Kandidate  
**4** Parti Parlamentare



Gra Kandidate



Gra të Zgjedhura



### Zgjedhjet Lokale 2003

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD+PR+PBL	60	0	23	0
PS	59	1	33	0
PBDNJ	22	3	2	0
PDS	44	1	1	0
PLL	3	2	0	0
PSD	32	2	0	0
PDR	31	2	0	0
Independent	19	1	0	0
PBK	16	0	0	0
PDK	12	0	0	0
PKSH	10	0	0	0
PSH	9	0	0	0
PBD	3	0	0	0
PBKD	3	0	0	0
PESH	2	0	0	0
PAP	2	0	0	0
Pkons	2	0	0	0
PSHA	1	0	0	0
PRDSH	1	0	0	0
PKDSH	1	0	0	0
PMP	1	0	0	0
PSKSH	1	0	0	0
PASSH	1	0	0	0
PBKDSH	1	0	0	0

**380** Kandidate

**24** Parti

**0** Gra të Zgjedhura

### Zgjedhjet Lokale 2007

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	42	0	23	0
PS, LSI, PSD, PDS, AD	51	4	25	1
PD, PR	9	0	5	0
PD, PAA	3	0	1	0
PKSH	16	0	0	0
PBDNJ	11	0	3	0
I Pavarur	27	1	0	0

**195** Kandidate

**7** Parti

**1** Gra të Zgjedhura

### Zgjedhjet Lokale 2011

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD	49	2	28	0
PS	63	2	32	2
LSI	11	0	2	0
PR	2	0	1	0
PBDNJ	1	0	0	0
LZHK	1	0	0	0
PKSH	1	0	0	0
PÇSH	1	0	0	0
I Pavarur	2	1	0	0

**136** Kandidate

**9** Parti

**2** Gra të Zgjedhura

### Zgjedhjet Lokale 2015

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
APPD*	59	3	38	8
ASHE*	45	3	13	2
PBDNJ	5	0	0	0
PFM	2	0	0	0
AP	3	0	0	0
I Pavarur	13	1	0	0

**158** Kandidate

**6** Parti

**10** Gra të Zgjedhura

### Zgjedhjet Lokale 2019

Partia Politike	Kandidatë Burra	Kandidate Gra	Burra Fitues	Gra Fituese
PD*	0	0	0	1
PS	53	8	52	8
BD	17	3	0	0
PKSH	2	0	0	0
MEGA	1	0	1	0
SHN	4	0	0	0
PKKA	1	0	0	0
AMIE	1	0	0	0
I Pavarur	6	0	0	0

**96** Kandidate

**8** Parti

**9** Gra të Zgjedhura

\* PD nuk mori pjesë në këto zgjedhje

## Organizatat e Grave në Partitë Politike të Djathta

### LDGSH - Lidhja Demokratike e Gruas së Shqipërisë

Partia Demokratike e Shqipërisë është themeluar në vitin 1990 dhe është partia më e madhe konservatore në Shqipëri. Themeluar pas Lëvizjes Studentore kundër regjimit të kohës si një parti e fortë anti-komuniste, me pjesën më të madhe të simpatizantëve të saj të përfaqësuar nga disidentët e përndjekur politikisht nga regjimi diktatorial komunist, ajo përfaqëson partinë e parë opozitare në Shqipëri pas më shumë se 45 vjet diktaturë komuniste. Në mars të vitit 1992 Partia Demokratike fitoi zgjedhjet e dyta pluraliste në historinë e Shqipërisë dhe u pa si flamurtarja kryesore e ideve të reformës demokratike. Ajo mori përgjegjësinë për të zbatuar reformat për kthimin e vendit nga një regjim komunist në një demokraci liberale të tregut të lirë – dhe për të nisur kështu rrugën e Shqipërisë drejt integritimit në botën perëndimore.

Gruaja e parë që u përfshi që në fillimet e formimit të partisë ishte Merita Zaloshnja<sup>44</sup>, e cila gjithashtu ishte e para dhe e vetmja grua në bordin e parë ekzekutiv të zgjedhur të kryesisë së Partisë Demokratike.

Më 18 gusht 1991 u krijua Lidhja Demokratike e Gruas (LDGSH) si një organizatë vullnetare e grave shqiptare bazuar në parimet dhe vlerat e demokracisë liberale në Shqipëri, me synimin për të nxitur pjesëmarrjen e grave në politikëbërje dhe vendimmarrje brenda Partisë Demokratike të Shqipërisë. Ndër vite, LDGSH-ja është drejtuar nga Flutura Hasko, Antoneta Luli, Marieta Zace dhe Albana Vokshi (drejtuese aktuale e LDGSH-së që nga viti 2009). LDGSH ka qenë e angazhuar në nivel lokal dhe kombëtar në promovimin e përfaqësimit të grave në Partinë Demokratike, si dhe më gjerësisht në politikë.

<sup>44</sup>[https://en.wikipedia.org/wiki/Democratic\\_Party\\_of\\_Albania](https://en.wikipedia.org/wiki/Democratic_Party_of_Albania)

Disa nga aktivitetet kryesore të ndërmarra nga LDGSH janë angazhimi në politikëbërjen e partisë, përgatitja e strategjisë dhe planit të veprimit për barazinë gjinore për partinë, organizimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për anëtarësinë e saj, përfshirja në diskutime dhe fushata ndërgjegjësimi për çështje sociale dhe politike (si kuotat gjinore për gratë candidate në zgjedhjet lokale dhe qendrore, nisma ndërgjegjësuere për kancerin e gjirit, etj.), organizimi i grave dhe strukturave të LDGSH-së gjatë fushatave elektorale, etj.

LDGSH është pjesë e organizatave ndërkombëtare si, **IDU Women** dhe **Organizata e Grave të Partisë Popullore Evropiane**. Drejtuesja aktuale e LDGSH Albana Vokshi u zgjodh në vitin 2022 në posin e **Nën-kryetares së EPP Women**.

Më specifikisht disa nga aktivitete e LDGSH ndër vite janë:

- » Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtarë në lidhje me barazinë gjinore, pormovimin e grave në politikë, etc.
- » Aktivitete për rritjen e kapaciteteve, në fushatat zgjedhore, barazinë gjinore, etj.
- » Protesta tematike (mbrojtja e shtëpive, 8 marsi, seksizmi ne Parlament)
- » Aktivitete me karakter social, Fushata ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit, Aktivitete për dhunën në familje, takime për femijët me aftësi ndryshe.
- » Aktivitete për fuqizimin ekonomik të gruas
- » Aktivitete letrare e kulturore
- » Anketa (për programin qeverisës të PD për barazinë gjinore)
- » Hartimi i programit të PD / LDGSH: për fuqizimin e rolit të Gruas në Zhvillim e Integrim (2012) & programi i barazise gjinore (2021)

### Struktura Aktuale e LDGSH:



**85** Numri i Degëve  
**700** Numri i Grup Seksioneve  
**10,000** Anëtare

### 3 shtyllat kryesore të Programi të LDGSH për barazinë gjinore:

- » *Shanse të barabarta*
- » *Barazi në Vendimmarrje*
- » *Lufta kundër Dhunës me bazë gjinore*

### Arritjet Kryesore të LDGSH:

*Rritja e kuotes partiake: nga 25% ne 30%*

*PD dhe LDGSH u bënë iniciatore të Rezolutës në Kuvend për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje (2017).*

*Iniciatore dhe mbeshtetes për ndryshime në Kodin zgjedhor për vendosjen e kuotës prej 50% në Këshillat Bashkiakë.*

*2021: 50 zonja në listën e kandidatëve për deputetë e ku arritën të fitojnë 29 %.*

*Gratë përbëjnë 30% të kryesive në çdo degë, të Këshillit Kombëtar dhe*

*Gratë drejtojnë tre Komisione të rëndësishme parlamentare e kanë qenë ndër më aktivet në aksionin opozitar.*

*Ndryshimi i Statutit te PDSH dhe rritja e përfaqësimit te LDGSH dhe FRPD në Organet e PDSH*

\*\*\*

Ndonëse parti të vogla parlamentare, Partia Republikane e Shqipërisë (PR) dhe Partia për Drejtësi dhe Integritim (PDIU) kanë krijuar Forumet e Gruas si organizata partnere të partisë, të cilat janë kryesisht më aktive gjatë fushatave elektorale.

Forumi i Gruas i Partisë Republikane u themelua në vitin 1991 si një organizatë partnere e Partisë Republikane të themeluar në 10 janar 1991. Drejtuesja e parë e forumit ishte Tamara Luarasi, mësuese. Më pas Forumi i Gruas u drejtua nga Mirela Bogdani, Xhuljeta Jaho, Teuta Boci, Suzana Gjevori, Brunilda Laboviti dhe aktualisht drejtohet nga Erjola Keci. Një nga gratë më të spikatura e cila përfaqësoi Forumin në kabinetin qeveritar ishte ish-Ministrja e Shëndetësisë znj. Anila Godo.

Grupi aktual parlamentar i Partisë Republikane përbëhet nga 2 gra deputete dhe 2 burra deputetë (të zgjedhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, si pjesë e listës PD-AN (Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim). Në statutin e Partisë Republikane saktësohet se: Kryetarja e Forumit të Gruas Republikane është njëkohësisht edhe anëtare e Kryesisë së Partisë. Kryesia e Partisë Republikane përbëhet nga 23 anëtarë, nga të cilët 8 i përkasin Forumit të Gruas. Dy nga degët e Partisë Republikane, përkatësisht në Lushnje dhe Devoll, drejtohen nga koordinatoret e Forumit të Gruas, znj. Mirela Lipe dhe znj. Diana Kapo.

### 3.1 Gjetjet: komponenti sasior – anketa



Për të vlerësuar pozitat, qasjen dhe sfidat e grave në partitë e spektrit të djathtë, në kuadër të këtij hulumtimi Partia Demokratike është përzgjedhur si rast studimor duke qenë se ajo përfaqëson partinë më të madhe të djathtë në vend.

- ✓ Karakteristikat e grave anëtare të Partisë Demokratike pjesëmarrëse në Anketë.
- ✓ Përvoja e grave të Partisë Demokratike në politikë dhe si pjesë e strukturave partiake.
- ✓ Sfidat e grave anëtare të Partisë Demokratike në politikë dhe brenda partisë.

Gjatë hulumtimit për përgatitjen e këtij raportimi është vërejtur se ka një mungesë të informacionit zyrtar dhe të aksesueshëm për Forumet e Grave të Partive Politike, si dhe mungesë të arkivave dhe publikimeve të informacionit lidhur me historikun dhe aktivitetet e realizuara nga Forumet. Për këtë arsye, u zhvillua një sondazh online për të vlerësuar pozitat dhe barrierat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në politikë në përgjithësi dhe më konkretisht në partitë e spektrit të djathtë; si dhe për t'i dhënë zë rekomandimeve të tyre lidhur me hapat e mëtejshëm që duhet të ndërmerren për të garantuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave brenda partisë. Sondazhi u krye gjatë periudhës qershor–korrik 2022 dhe në të u përfshinë 102 gra anëtare të Partisë Demokratike të Shqipërisë, e cila përfaqëson edhe partinë më të madhe të djathtë në vend.

Anketa u hartua bazuar në tre kategori kryesore: historia dhe përvoja personale e grave anëtare, përvoja e grave në politikë dhe si pjesë e strukturave partiake, si dhe sfidat brenda për brenda partive. Gjithashtu, një numër i përzgjedhur grash anëtare të Partisë Demokratike u intervistuan personalisht, për një njohje më thellë të përvojës së tyre dhe për ndarjen e eksperiencave të tyre dhe rekomandimeve. Për informacion në lidhje me metodologjinë e kërkimit dhe pyetësonin e anketës, ju lutemi konsultoni Shtojcat 1 dhe 2 të këtij raporti.

### 3.1.1 Karakteristikat e grave anëtare të Partisë Demokratike pjesëmarrëse në Anketë:


Ky seksion ofron informacion mbi karakteristikat socio-demografike të grave dhe rrugëtimin e tyre politik në parti, si një instrument i dobishëm për të përcaktuar profilin e grave anëtare dhe mundësitë e leadershipit në të gjithë zinxhirin e furnizimit me prurje brenda partisë.

**Profilet e Grave:** Anketa u krye me përfshirjen e 102 grave anëtare të Partisë Demokratike, me një larmishmëri të statusit të tyre politik, duke përfshirë 7 deputete në Kuvendin e Shqipërisë, 15 anëtare në Këshilla Vendorë, dhe 78 gra anëtare të cilat mbajnë poste të ndryshme vendimmarrëse brenda strukturave partiake. Pozicione të tilla përfshijnë drejtuesen e Organizatës së Grave dhe Rinisë, zëdhënësen, ndihmësen e kryetarit, shefen e grup-seksionit dhe sekretaren e grup-seksionit.



Më konkretisht, karakteristikat socio-demografike të grave që morën pjesë në anketë janë si më poshtë:


» Shumica e grave kanë arsim të lartë. 36.2% e grave anëtare të intervistuar kanë diplomë universitare, 45.1% kanë diplomë pasuniversitare dhe 6% kanë doktoraturë. Vetëm 9,7 % e grave anëtare të intervistuar kanë arsim të ulët.



» Shumica e grave pjesëmarrëse në anketim kanë më shumë gjasa të punojnë në profesionet e tyre ndërkohë që janë të përfshira në jetën politike. 75.5% e grave anëtare deklaruan se punojnë në sektorë të tjerë paralelisht me përfshirjen në parti, ndërsa vetëm 24.5% janë të angazhuara ekskluzivisht në politikë.



» 59,2 % e grave të intervistuar ishin të angazhuara në mënyrë aktive në strukturat partiake në nivel kombëtar dhe lokal.



» 60.4% e grave anëtare të intervistuar ishin të martuara, 29.7% ishin beqare dhe 9.9% kishin tjetër status civil, duke përfshirë divorcin, partneritetin, etj.

**Rruga për në parti:** Shumica e grave anëtare të intervistuar deklaruan se i janë bashkuar partisë përmes përfshirjes së tyre në organizatat e partisë, përkatësisht Organizatën e Rinisë dhe Grave (67.6%). Kjo e dhënë tregon rolin e rëndësishëm që kanë luajtur Organizatat e Grave dhe Rinisë në rekrutimin e grave dhe vajzave brenda partisë. Mënyra të tjera të hyrjes në parti përfshijnë ato që lidhen me familjen dhe traditën (58.8%) dhe me pjesëmarrjen në aktivitete partiake (56.9%). 29.4% e grave anëtare të intervistuar raportuan se janë ftuar nga partia për të kandiduar për poste të ndryshme ose për t'u angazhuar në strukturat e partisë.


### 3.1.2 Partia Demokratike – përvoja e grave në politikë dhe pjesë e strukturave partiake:

Ky seksion jep informacion mbi organizimin e brendshëm të partisë, demokracinë e brendshme dhe transparencën, strukturat e grave dhe mbështetjen ndaj grave anëtare në këndvështrimin e grave anëtare të PD-së pjesëmarrëse në anketim.

**Organizimi i Partisë:** Sikurse përmendur më lartë gjatë studimit, për garantimin e barazisë gjinore dhe mundësive të barabarta rëndësi të spikatur ka vendosja e rregullave dhe rregulloreve të brendshme të partive politike. Rregullat dhe rregulloret e brendshme të Partisë Demokratike janë marrë në vlerësim për të kuptuar nivelin e përpjekjeve dhe angazhimit të partisë politike për të rekrutuar gra dhe për të krijuar mjedisin për pjesëmarrjen e barabartë dhe lidhshmërinë e grave anëtare brenda partisë.

Në këtë kontekst, në funksion të vlerësimit të pranisë, transparencës dhe ndikimit të rregullave dhe rregulloreve të brendshme mbi gratë anëtare, pjesëmarrëseve iu kërkua të ndajnë në anketë vlerësimin e tyre nëse partia e tyre politike ka masa dhe rregullore të veçanta për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në strukturat dhe në postet drejtuese partiake.

**Figura 1: A ka partia juaj politike një qëndrim zyrtar, manifest apo rregullore për sa vijon?**



- » 88.23% e grave raportuan se partia e tyre ka vlera dhe parime të barazisë gjinore.
- » 80,39% pohuan se partia e tyre ka vendosur masa të veçanta (kuota apo mandate të rezervuara) për të siguruar një përfaqësim të balancuar në strukturat e ndryshme partiake, si dhe pozicione ekzekutive, në komitete dhe komisione.
- » 61.76% e grave anëtare kanë treguar se partia e tyre ka masa/projekte të veçanta për të rritur rekrutimin e grave dhe vajzave në parti.
- » 46.07% e grave anëtare raportuan se nuk e dinin nëse partia e tyre ka një komision për barazinë gjinore brenda strukturës së partisë.
- » 57,84% e grave anëtare nuk kanë pasur informacion nëse partia e tyre ka protokolle për parandalimin dhe ndërhyrjen kundrejt ngacmimit seksual dhe dhunës brenda partisë.
- » Vetëm gjysma e grave pohuan se partia e tyre ka një program zyrtar për të rritur ndërgjegjësimin e anëtarëve të saj për çështjet e barazisë gjinore.
- » 58,82% nuk e dinin nëse partia ka burime specifike të ndara për gratë kandidate gjatë zgjedhjeve. Gjithashtu, vetëm 20.58% e grave pohuan se partia e tyre ka burime të ndara për kandidatet gra, kryesisht si mbështetje logjistike gjatë fushatave elektorale.

Këto shifra janë shumë domethënëse pasi ato na ofrojnë një pasqyrë të transparencës së partive politike dhe disponueshmërisë së informacionit për anëtarët e tyre. Kjo tregon se është e rëndësishme që edhe kur vendosen rregulla dhe rregullore të brendshme, duhet që anëtarët të ketë mjaftueshëm informacion –përndryshe këto rregulla dhe rregullore rezultojnë të mos jenë efektive. Për më tepër, mungesa e informacionit shkakton edhe vulnerabilitet për anëtarët e partisë.

#### **Komentet më të shpeshta nga pjesëmarrësit e sondazhit:**




“Duhet të ketë më shumë burime financiare për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, veçanërisht gjatë zgjedhjeve. Si mund të kandidojnë gratë nëse ato nuk kanë akses në burime?”

“Nuk e di nëse ka struktura të tjera brenda partisë të cilat mbështesin barazinë gjinore dhe gratë, përveç Organizatës së Grave”.

“Të gjitha janë të shkruara e zeta mbi të bardhë, por ka rëndësi që rregullat dhe mbështetja të mos mbeten në letër. Ne duhet të jemi një parti që advokon zbatimin e këtyre rregullave dhe që mundëson mbështetje reale për gratë”.

**Figura 2: A mendoni se numri i grave në strukturat e ndryshme të partisë suaj është i mjaftueshëm?**



Në vijim pjesëmarrëset u pyetën nëse e konsiderojnë si të mjaftueshëm numrin e grave brenda strukturave partiake. Shumica e grave anëtare u përgjigjën negativisht.

Konkretisht, 79,4% e grave anëtare të PD-së u shprehën 'Jo' dhe 7,8% u shprehën 'Nuk e di', që do të thotë se vetëm 12,7% e grave të intervistuar ishin të kënaqura me nivelin aktual të përfaqësimit të grave dhe vajzave brenda partisë.

## Komentet më të shpeshta nga pjesëmarrësit e sondazhit:



"Në zonat rurale ka më pak gra dhe angazhimi i tyre kufizohet në pozicione të ulëta duke mos u dhënë atyre mundësinë për të marrë poste drejtuese."

"Grup-seksionet, veçanërisht ato në zonat periferike, dominohen nga burrat, duke bërë që rruga e hyrjes se grave në parti të jetë vetëm përmes kuotave."

"Kuotat janë një metodë e shkëlqyer për të sjellë më shumë gra në tryezë, por gjithashtu ato pengojnë sistemin e meritokracisë dhe konkurrencës së ndershme. Në shumë raste gratë të cilat nuk flasin promovohen, ndërsa gratë më të forta shtyhen mënjanë."

"Ne kemi nevojë për më shumë gra në poste drejtuese për të ndryshuar kulturën e partisë."

**Organizata e Grave:** Për të mësuar më shumë rreth dinamikës dhe rolit të Organizatës së Gruas në parti, grave anëtare të Partisë Demokratike iu kërkua të identifikonin detyrat kryesore të Organizatës së Gruas. Të dhënat tregojnë se më së shumti gratë anëtare ranë dakord mbi detyrat kryesore të Organizatës së Grave, si më poshtë:


- » 76.47% Ofron mbështetje organizative dhe logjistike për partinë politike.
- » 73.52% Jep kontribut në vendimmarrje në parti.
- » 74.50% Angazhohet për promovimin e pjesëmarrjes së grave në jetën politike.
- » 78.43% Mbështet kandidatet gra gjatë zgjedhjeve.
- » 67.64% Ofron mbështetje për gratë e zgjedhura në parlament.
- » 76.47% Mobilizon votën e grave përpara zgjedhjeve.
- » 72.54% Advokon për çështjet gjinore brenda partisë.

Gratë anëtare të PD-së e përshkruan Organizatën e Gruas (LDGSH) si një strukturë thelbësore brenda partisë, e cila siguron jo vetëm pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në parti dhe në jetën publike, por gjithashtu ndihmon për shtytjen përpara të axhendës për barazi gjinore brenda partisë, si edhe për fitoren e fushatave zgjedhore përmes komunikimit të gjerë me votuesit dhe mbështetjes së kandidatëve.

Gjithashtu, grave anëtare të PD-së iu kërkua të renditnin fuqinë efektive të Organizatës së Gruas. Më shumë se gjysma e grave të anketuara e përshkruan Organizatën e Gruas si "shumë të rëndësishme" për pjesëmarrjen e grave në parti (51%), ndërsa 35.3% e renditnin si "të përshtatshme" dhe 10.8% e tyre si "jo shumë efektive".

Një nga gratë e anketuara komentoi se: "Organizata e grave promovon gratë kandidat gjatë fushatave elektorale. Është një mbështetje unike që kemi nga partia". Të tjera anëtare gra u shprehën se pavarësisht se Organizata e Grave ishte një strukturë e rëndësishme, asaj i mungonin aftësitë organizative dhe mbështetja nga Partia.

### Roli i Organizatës së Grave në ërffshirjen e grave në parti





## **Komentet më të shpeshta nga pjesëmarrësit e sondazhit:**



“LDGSH ka mundur të integrojë kuotat gjinore brenda partisë dhe ka bërë shumë për gratë, por i mungon fuqia në proceset vendimmarrëse brenda partisë”.

“Mungesa e mbështetjes dhe mungesa e fondeve kanë ulur ndjeshëm ndikimin e saj në parti dhe në komunitet”.

“LDGSH duhet të ketë një strukturë të qëndrueshme, rregullore dhe përgjegjësi ndërmjet anëtarëve, në mënyrë që të gjithë të kontribuojnë siç duhet.”

Në po këtë linjë mendimi, pjesëmarrëseve iu kërkua të paraqesin sugjerimet e tyre bazuar në përvojën personale, njohuritë dhe nevojat e tyre, mbi mënyrë e forcimit të Organizatës së Grave brenda partisë.


1. Forcimi i fuqisë vendimmarrës brenda partisë.
2. Krijimi i një strukture organizative më efektive.
3. Alokimi i fondeve dhe burimeve për Organizatën e Grave.
4. Përmirësimi i komunikimit dhe PR dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet degëve lokale.
5. Zhvillimi i takimeve dhe aktiviteteve të rregullta me tematika të ndryshme, edhe jashtë sferës politike.
6. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve dhe mbështetja e organizatës me zhvillimin e aftësive teknike.
7. Investimi tek gra model-shoqëror përmes trajnimeve dhe programeve të mentorimit.
8. Krijimi i grupeve këshillimore me profesioniste gra nga fusha të ndryshme dhe investimi në kapacitetet kërkimore të Organizatës së Grave.

Përmbledhtazi, vërejmë se gratë anëtare janë të vetëdijshme për rolin e rëndësishëm të Organizatës së Gruas brenda partisë, për çështjet dhe sfidat e brendshme organizative, si dhe për nevojën për më shumë mbështetje, veçanërisht në lidhje me qasjen në burime.


### ***Ngritja e kapaciteteve dhe aftësive:***

Për të siguruar pjesëmarrjen e grave në strukturat e brendshme partiake dhe për të rritur përfaqësimin e tyre në politikë dhe jetën publike, është thelbësore që atyre t'u ofrohet mundësia për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive, duke krijuar hapësirën e nevojshme për të diskutuar politika dhe çështje specifike dhe për t'u rrjetëzuar me njëra-tjetrën. Në këtë kontekst, grave anëtare të intervistuar iu paraqit një listë trajnimesh dhe iu kërkua të zgjidhnin në cilat to kishin marrë pjesë dhe subjektin që i kishte ofruar ato trajnime. Të dhënat tregojnë sa më poshtë:


- » 64.70% e grave anëtare të intervistuar janë trajnuar për fushata zgjedhore.
- » 58.82% e grave anëtare të intervistuar kanë marrë pjesë në trajnim mbi integrimin gjinor.
- » 56.86% e grave anëtare të intervistuar kanë ndjekur trajnime mbi komunikimin dhe të folurën në publik.
- » 44.11% e grave anëtare të intervistuar kanë marrë pjesë në një trajnim mbi lidhshmërinë.
- » Më pak se gjysma (41.17%) e grave anëtare të intervistuar kanë njohuri mbi funksionet partiake dhe janë trajnuar mbi këtë temë.
- » 31.37% e grave anëtare të intervistuar kanë marrë pjesë në trajnime mbi avokimin legjislativ.
- » 33.33% e grave anëtare të intervistuar kanë marrë pjesë në një trajnim mbi Mediat.
- » Vetëm 19.60% e grave anëtare të intervistuar kanë marrë pjesë në trajnime mbi buxhetimin gjinor.




Fushata Elektorale



Media



Komunikimi Publik



Lidership

Aktorët të cilët kanë dhënë mbështetjen më të madhe përmes trajnimeve të përmendura nga gratë anëtare të anketuara përfshijnë Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Organizatat Ndërkombëtare, si Instituti Kombëtar Demokratik (National Democratic Institute, NDI), Fondacioni Konrad Adenauer (Konrad Adenauer Stiftung), Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje”, Instituti Ndërkombëtar Republikan (International Republican Institute, IRI), Fondacioni Jarl Hjalmarson (Jarl Hjalmarson Stiftung), Fondacioni Robert Schuman (Romert Schuman Stiftung) etj., si edhe vetë Partia Demokratike.

### 3.1.3 Sfidat e grave anëtare të Partisë Demokratike në politikë dhe brenda partisë


#### Sfidat e grave anëtare:

Ky seksion jep informacion mbi sfidat dhe barrierat kryesore me të cilat përballen gratë pjesë e kësaj ankete në angazhimin e tyre në politikë dhe si deputete të Partisë Demokratike. Ata u pyetën rreth problemeve dhe vështirësive me të cilat ato përballen brenda partisë referuar dimensioneve të ndryshme, si më poshtë:

#### Sfidat si gra të përfshira në politikë:

Shumica e grave anëtare të intervistuar raportuan sfidat që vijojnë: të qenit grua në politikë (51%), mungesa e stabilitetit dhe mundësive për të avancuar në karrierën politike (38.2%), organizimi i brendshëm dhe funksionimi i partisë, p.sh. demokracia e brendshme, transparenca etj. (37.3%).


**Figura 3: Cila mendoni se është çështja më sfiduese për një grua të angazhuar në politikë? (Mund të zgjidhni deri në 3 opsione)**



#### Sfida brendapërbrenda partisë:

Në vijim, gratë anëtare të anketuara u pyetën lidhur me mendimin e tyre rreth faktorëve kryesorë të cilët kanë ndikim negativ sa i përket hyrjes së grave në parti politike; të renditura duke nisur nga ato më të përmendurit: mungesa e mbështetjes financiare nga partia politike (54,90%), mungesa e përkushtimit për identifikimin, trajnimin dhe mentorimin e kandidateve gra dhe vajza për poste (44,11%), si edhe mungesa e mbështetjes nga meshkujt e tjerë brenda partisë politike (36,27%).

**Figura 4: Sipas jush sa ndikim kanë faktorët e mëposhtëm në frenimin e hyrjes në partitë politike të grave?**



### Sfidat e përjetuara si pjesë e partisë politike:

Në përfundim, pjesëmarrëseve iu kërkua të ndajnë përvojat e tyre brenda partisë – dhe ato pohuan se kishin përjetuar vështirësitë e mëposhtme:

- » 78,43% e grave anëtare të intervistuar theksuan si aspektin më sfidues kulturën patriarkale dhe dominimin e burrave brenda partisë.
- » 41,17% e grave anëtare të intervistuar evidentuan rregullat dhe normat e pashkruara si pengesa brenda partisë.
- » 35,29% e grave anëtare të intervistuar janë përballur me sjellje seksiste dhe barriera gjinore.
- » 34,31% e grave anëtare të intervistuar kanë përjetuar komente përçmuese ose ngacmuese brenda partisë.
- » 26,47% e grave anëtare u shprehën se kanë hasur mungesa të qasjes në burime apo informacion çka ka çenuar punën dhe suksesin e tyre.

### Komente nga pjesëmarrëse në anketë:



*“Bullizmi, seksizmi dhe gjuha e urrejtjes në mediat sociale përbëjnë aspekte normale të të qenit grua në politikë.”*

*“Politika konsiderohet si punë për burra. Mentaliteti i vjetër dhe patriarkalizmi vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për gratë në politikë.”*

*“Mungesa e informacionit dhe transparencës brenda partisë penalizon në mënyrë të veçantë gratë.”*

*“Përgjegjësitë familjare i konsideroj si një nga sfidat e mia më të mëdha. Të balancosh politikën dhe familjen është jashtëzakonisht e vështirë, sidomos gjatë fushatave elektorale, dhe nuk se jepet mbështetje në këtë aspekt...”*

*“Gratë në karrierë nuk trajtohen në të njëjtën mënyrë sikurse burrat. Ne mund të jemi shumë konkurruese dhe të afta, por jetojmë në një shoqëri dhe për rrjedhojë edhe në një parti që është shumë patriarkale...”*



### Histori, sfida dhe rekomandime nga gratë anëtare të Partisë Demokratike

Në kuadër të këtij raporti, në funksion të një vlerësimi sa më të thelluar të pozitive, qasjes dhe sfidave të grave në Partinë Demokratike, krahas anketës, janë realizuar intervista personale me gra në pozicione vendimmarrëse, me formim dhe eksperiencë të ndryshme brenda partisë. Më poshtë vijon një përmbledhje e këtyre intervistave:

#### ALBANA VOKSHI



Albana Vokshi, e lindur më 24 shkurt 1971, është diplomuar në Universitetin e Tiranës për Inxhinieri dhe ka përfunduar studimet Master në Universitetin Columbia në SHBA. Albana është deputete e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që përfaqëson Partinë Demokratike. Ajo është një figurë e spikatur e Partisë Demokratike, duke qenë deputete që nga viti 2009. Në Kuvendin e Shqipërisë ka mbajtur postin e Kryetares së Komisionit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 2021, dhe në legjislaturat e mëparshme ka qenë Kryetare e Komisionit për Arsimin dhe Median 2017–2019, Kryetare e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 2013–2017, dhe Kryetare e Nënkomitetit për Mbrojtjen Gjinore dhe të Fëmijëve 2009–2013. Gjatë aktivitetit të saj ajo është fokusuar në krijimin e politikave për shërbimet shëndetësore pa pagesë ose me pagesë të ulët, punësimin e grave dhe në mjediset e edukimit dhe trajnimit për gratë. Si pjesë e strukturave të Partisë Demokratike, zonja Vokshi ka qenë Kryetare e Organizatës së Grave të PD-së “Lidhja Demokratike të Gruas Shqiptare” (LDGSH), anëtare e Bordit Ekzekutiv të PD-së që nga viti 2009 dhe aktualisht Kryetare e Komisionit Zgjedhor të PD-së.

Në cilësinë e Kryetares së Organizatës së Grave të Partisë Demokratike, Albana shprehet se roli i Organizatës së Gruas brenda partisë ka ardhur duke u rritur vit pas viti, falë punës, organizimit dhe kontributit të grave dhe vajzave anëtare – dhe nënvizon numrin në rritje të grave në poste drejtuese brenda partisë të cilat vijnë nga LDGSH.

Disa nga sfidat kryesore për gratë në politikë në Shqipëri, sipas zonjës Vokshi janë qasja në financat dhe burimet politike, stereotipet gjinore dhe dhuna ndaj grave në politikë. Një nga sfidat kryesore referuar qëndrueshmërisë së Organizatës së Grave është mbështetja financiare dhe qasja e saj në burime. Me qëllim zbatimin sa më mirë të detyrave të saj dhe luajtjen e rolit si pika kyçe e rekrutimit dhe fuqizimit të grave brenda partisë, Organizata do duhet të përvijojë me riorganizimin e saj periodik, rritjen e kapaciteteve të anëtarësisë së saj, krijimin e mundësisë për një përmirësim të infrastrukturës për adresimin e çështjeve të grave jo vetëm brenda partisë dhe në politikë, por edhe të çështjeve sociale që ndikojnë tek gratë në shoqëri. Për të fuqizuar dhe garantuar pjesëmarrjen e grave në partitë politike, kanë rëndësi të posaçme përmirësimi, harmonizimi dhe sensibilizimi gjinor i rregulloreve të brendshme dhe proceseve vendimmarrëse partiake. Është thelbësore të mbështeten gratë anëtare të partisë, në nivel lokal dhe qendror, duke ofruar mundësi për ngritje kapacitetesh, rrjetëzim dhe bashkëpunim, si dhe për promovimin e më shumë grave dhe aktiviteteve të Organizatës së Grave në media dhe rrjetet sociale, shkëmbimin e praktikave të mira përmes krijimit të rrjeteve mbështetëse rajonale dhe ndërkombëtare, etj.

## LAJLA PERNASKA



Lajla Pernaska është një politikane e djathtë shqiptare, e zgjedhur 2 herë deputete në Kuvendin e Shqipërisë, me përvojë të gjerë në politikë, fushën e të drejtave të njeriut dhe çështjeve gjinore, si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Zonja Pernaska ka qenë e angazhuar në sferën publike si aktiviste e shoqërisë civile dhe si e zgjedhur politike. Ajo ka qenë e angazhuar në Partinë Demokratike që nga viti 1995. Ka qenë anëtare e Kryesisë së LDGSH (1995–1998), Drejtuese e Departamentit të Çështjeve Sociale të PD-së (1999–2001), anëtare e Bordit Ekzekutiv të PD-së në degën Tiranë (2009–2013), anëtare e Këshillit Kombëtar të PD-së (2010–2015), anëtare e Bordit Ekzekutiv të PD-së (2011–2014) dhe koordinatore dhe përfaqësuese në Kuvend për Njësinë Nr. 2, Qarku Tiranë (2005–2013).

Ajo ka një profil profesional si eksperte me një gamë të gjerë njohurish dhe përvoja në legjislacion, politikëbërje, planifikim, hartim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të programeve/projekteve, në fushën e shëndetit publik, barazisë gjinore dhe çështjeve sociale. Ajo është angazhuar në punën për reformimin e sistemit shëndetësor në Shqipëri, si edhe përgatitjen e strategjive dhe politikave në fushën e shëndetësisë, që nga viti 1995. Eksperte e perspektivës gjinore për politikën dhe programet e zhvillimit, që nga viti 1996, me njohuri të thelluara në fushën e lidhësive politik, organizimit dhe menaxhimit, me përvojë në bashkëpunime të programeve për zhvillim me Organizata Ndërkombëtare – si UNICEF, UNDP, Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, USAID, Banka Botërore dhe OBSH. Gjatë karrierës së saj politike, zonja Pernaska është zgjedhur edhe në poste drejtuese në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Lidhur me eksperiencën e saj, zonja Pernaska gjatë intervistës shprehet: “Nuk ka qenë e lehtë për mua të kandidoj për deputete në Kuvend në një moment kur Partia nuk ishte e hapur ndaj grave dhe çështjeve të barazisë gjinore, por me këmbënguljen e duhur kandidova dhe fitova mandatin tim të parë parlamentar në vitin 2005, pas plot 10 vitesh kontribut aktiv në parti.”

Zonja Pernaska pohon se Partia duhet të investojë më shumë për hapjen reale ndaj konkurrencës brenda partisë dhe duhet të garantojë barazi gjinore jo vetëm në përfaqësim, por edhe në aspektin rregullator dhe në politikëbërje. Është thelbësore të investohet në rivendosjen e besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit të grave të djathta me strukturat e partisë dhe të investohet më shumë në projekte dhe iniciativa për ngritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave anëtare të partisë. Sipas zonjës Pernaska, Organizata e Grave e partisë duhet të ketë një organizim më efektiv dhe më të aksesueshëm në mënyrë që të forcojë pozitën e saj brenda partisë.

## ORJOLA PAMPURI



Orjola Pampuri ka lindur më 13 nëntor 1981 dhe ka ndjekur studimet e lartë pranë Universitetit të Tiranës ku mori diplomën Bachelor në Psikologji dhe pas do të përfundonte edhe studimet e Doktoraturës. Në shtator 2017 ajo bëhet deputete e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë. Ajo është psikologe karriere dhe profesoreshë pranë Universitetit të Shkencave Sociale dhe Mjekësisë në Shqipëri. Para se të hynte në politikë, ajo ka qenë e angazhuar si specialiste e shëndetit mendor pranë Institutit të Shëndetit Publik.

Gjatë intervistës, zonja Pampuri u shpreh se rruga e angazhimit të saj në politikë ka nisur përmes një ftese nga ana e Partisë Demokratike dhe ndau mendimin se është veçanërisht e rëndësishme që partia të ftojë dhe të angazhojë në mënyrë aktive gra profesioniste nga fusha të ndryshme. Ajo thekson se pavarësisht se arritjeve shumë pozitive në lidhje me barazinë gjinore, është ende e vështirë të flitet për garë me mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, pasi politika ende konsiderohet si “punë e burrave”.

Zonja Pampuri shprehet se beson më shumë tek cilësitë, se sa tek kuotat, dhe se kuotat mund të hiqen vetëm atëherë kur qytetarët dhe profesionistët do të kenë krijuar besim tek politika dhe kur intelektualët nuk do të hezitojnë të angazhohen në politikë. Nga përvoja e saj, zonja Pampuri vlerësoi se nuk është përballur me sfida për shkak të gjinisë përgjatë angazhimit të saj në politikë. Për një përfaqësim më të mirë dhe fuqizim të gruas në parti, zonja Pampuri sugjeron krijimin e një Komisioni për Barazimin Gjinor, si pjesë e Organizatës së Gruas, i cili komision mund të ndërmarrë nisma për hartimin e programeve dhe nismave ligjore për të drejtat e grave, si edhe mund të kontribuojë në iniciativë të mbledhjes së fondeve, trajtimin e çështjeve të grave parlamentare dhe të barazimit gjinor. Për funksionimin e këtij Komisioni do duhet të garantohen transparenca, meritokracia dhe vlerat si integriteti.

### BESMIRA PETRITI



Besmira Petriti ka lindur më 25.09.1988 në Korçë dhe ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, dhe më tej studimet për Masterin Shkencor "Politika dhe Qeverisja e Bashkimit Europian" në Institutin e Studimeve Europiane pranë Universitetit të Tiranës. Për më shumë se 10 vite, zonja Petriti ka ushtruar profesionin e saj si juriste në administratën publike në institucione si Ministria e Financave, Bashkia e Tiranës, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Zyra e Avokatit të Popullit. Nga tetori 2019 e në vazhdim, ajo është e angazhuar si pedagoge pranë "Beder University College", si edhe pedagoge me kohë të pjesshme në Kolegjin Qiriaz.

Origjina nga një familje e përndjekur politikisht e ka inkurajuar atë të investojë në pasionin e saj për politikën, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe drejtësinë. Në vitin 2007 ajo u zgjodh nën-kryetare e Organizatës Rinore të Partisë Demokratike të Fakultetit të Drejtësisë. Më pas ajo do të angazhohej në të gjitha fushatat vijuese elektorale të Partisë Demokratike dhe në drejtimin e proceseve zgjedhore. Në vitin 2015 u zgjodh nënkryetare e Organizatës Rinore të Partisë Demokratike. Në vitin 2017 ka qenë kandidate për deputete në Tiranë.

Gjatë intervistës së saj, zonja Petriti solli një këndvështrim ndryshe, si pjesë e Organizatës Rinore të PD-së, duke sjellë në vëmendje eksperiencat e saj personale gjatë angazhimit në politikë. Gjuha e urrejtjes për shkak të qëndrimeve të forta dhe sulmet, veçanërisht nga ana e funksionarëve burra, si dhe vështirësitë financiare gjatë kandidimit për deputete (për shkak se partia nuk kishte asnjë ndihmë apo buxhet të veçantë për kandidatet gra) ishin disa nga sfidat me të cilat ajo është përballur në rrugëtimin e angazhimit të saj politik. "Unë do të rekomandoja më shumë vëmendje ndaj grave dhe vajzave të cilat guxojnë të merren me politikë në një mjedis kaq të vështirë siç është ai i partive politike" – pohon zonja Petriti, ndërsa thekson nevojën për ofrimin e trajnimeve politike për gratë. "Rritja profesionale e grave në fushat e tyre ekspertizës do t'i shërbente një politikëbërjeje më të mirë dhe do të ishte jo vetëm në dobi të vetë grave, por edhe të Partisë Demokratike, si një alternativë qeverisëse."

### MIMOZA HAJDARMATAJ



Mimoza Hajdarmataj ishte pjesë e lëvizjes studentore të protestave kundër regjimit komunist dhe për demokratizimin e Shqipërisë në vitin 1990. Pas diplomimit në Inxhinieri Elektronike në vitin 1992, ajo nisi të punojë pranë Agjencisë Shtetërore të Telekomunikacionit, duke vijuar për një periudhë 15-vjeçare. Në vitin 2010 pas përfundimit të Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare, ajo shërbeu për një vit si Drejtoreshë e Drejtorisë së Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Në vitin 2011, ajo u emërua nga Kryeministri i Shqipërisë si Inspektore e Përgjithshme e Inspektoratit Qendror.

Në vitin 2015 zonja Hajdarmataj u zgjodh si deputetja e parë përfaqësuese e Kukësit, qarkut verior të Shqipërisë, duke zëvendësuar një nga deputetët burra që u tërhoq nga Kuvendi. Në vitin 2018 ajo themeloi Qendrën për "Gratë në Shërbimin Publik" në Shqipëri, e vendosur për të sjellë përvojën e saj të gjerë të fituar në ekzekutiv, politikë dhe në shoqërinë civile për fuqizimin dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave të reja.

Zonja Hajdarmataj ka hyrë në parti përmes aktiviteteve të ndryshme dhe thekson nevojën për të investuar tek gratë dhe të rinjtë jo vetëm gjatë fushatave elektorale, por edhe kur gratë janë ndërkaq në detyrë (në Parlament, në Këshilla Vendorë etj.).

## MERITA PONI



Merita Poni është pedagoge në Departamentin e Sociologjisë pranë Universitetit të Tiranës, ku ajo jep mësim dhe kryen kërkime në fushat e studimeve gjinore, sociologjisë, arsimit, kriminologjisë, terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, drejtësisë tranzicionale dhe metodave të kërkimit. Ajo ka studiuar Sociologji, Filozofi dhe Drejtësi në nivelin baçelor dhe ka përfunduar studimet master për politika sociale, master në arsim dhe doktoraturë në studime gjinore. Ajo ka përvijë të gjatë në qeverisjen lokale, mbrojtjen e të drejtave të njeriut si aktiviste dhe studiuese.

Gjatë mandatit të saj si këshilltare vendore si përfaqësuese e Partisë Demokratike, ajo drejtoi Aleancën e Grave Këshilltare Vendorë të Tiranës dhe trajnoi të tjera këshilltare gra lidhur me krijimin e aleancave dhe komisioneve për barazinë gjinore. Poni bashkëkryesoi Komisionin Komunal për Barazi Gjinore dhe Komisionin për Mbrojtjen Sociale dhe ka kontribuar në hartimin e Buxhetit me Përgjegjshmëri Gjinore për bashkitë, hartimin e politikave të mbrojtjes sociale dhe në komisionet komunale që ndërlidhen me çështje gjinore, si shëndetësia, arsimit, punësimi, transporti, gjyqësori, sistemi fiskal etj. Gjatë intervistës zonja Poni deklaroi se ka hyrë në parti përmes një ftese nga ana e Organizatës së Gruas, për të vijuar më tej me angazhimin e saj si kryetare e Organizatës së Gruas në një nga degët e Tiranës. Gjatë intervistës, zonja Poni nënvizoi se Organizata e Gruas nuk ka një pushtet real brenda partisë politike dhe se ka mangësi në qasjen në financa, burime njerëzore etj. Për çuarjen përpara të barazisë gjinore brenda partisë është e nevojshme rritja e kuotave gjinore në strukturat vendimmarrëse nga 30% në 50%.

Sipas intervistave rezulton se në vitet kur Partia Demokratike ka qënë në qeverisje janë ndërmarrë hapat dhe nismat ligjore si në vijim:

Miratimi dhe zbatimi i ligjeve dhe akteve ligjore të rëndësishme për barazinë gjinore, dhunën në familje, si dhe mbrojtjen nga diskriminimi:

- » Ratifikimi i Konventes së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore" (20.11.2006).
- » Ndryshimet në Kodin Penal (2007), ku ndër të tjera caktohet si rrethanë rënduese kryerja e veprës penale, e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë.
- » Miratimi i ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, (2008), ku një ndër parimet kryesore që parashikohet është mos diskriminimi për shkak të gjinisë.
- » Miratimi i Ligjit Nr. 9970 dt. 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", për mbrojtjen e qytetarëve nga çdo lloj diskriminimi që kryhet mbi bazë gjinie, garantimi i mundësive dhe shanseve të barabarta si për meshkujt edhe për femrat. Në ligj parashikohen për herë të parë edhe si kuota gjinore prej 30% për arrijtjen e balancës në organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv, gjyqsor e jetën publike.
- » Futja e kuotës gjinore në Kodin Zgjedhor ku sigurohet përfaqësimi minimal me 30% i gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e kandidimit për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore. sigurohet përfshirje mbi 30% të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.
- » Miratimi i Ligjit nr. 10.329, datë 30.09.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare" të ndryshuar".
- » Miratimi i Ligjit 10221 datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
- » Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2011- 2017, me planin përkatës të kostuar të veprimit.

Fuqizimi i strukturave për barazinë gjinore dhe dhunën në familje:

- » Krijimi në Kuvendin e Shqipërisë të Nënkomisionit Parlamentar për Barazim Gjinor dhe Çështjet e te Miturve.
- » Ngritja e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ) me (Urdhëri i Kryeministrit Nr. 3 datë 8.1.2009), si organ këshillimor pranë Këshillit të Ministrave për politikën gjinore.
- » Ngritja dhe fuqizimi i rrjetit të nëpunësve gjinorë në nivel qendror dhe vendor, gjë që ka bërë të mundur përfshirjen e politikave gjinore në politikën qeveritare në të gjitha nivelet qeverisëse.
- » Ngritja e institucionit të "Komisionit kundër Diskriminimit", si një institucion i pavarur që garanton mbrojtjen nga diskriminimi.
- » Ngritja e strukturave mbështetëse për viktimat e dhunës nëpërmjet funksionimit të Strehëzës së parë Kombëtare për të mbujtuarit e dhunës në familje.
- » Ngritja e Mekanizmit për Referimin e Rasteve të Dhunës në marrëdhëniet familjare.

## PËRFUNDIME

Ndërkohë që është shënuar një progres domethënës sa i përket pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në vendimmarrje në partitë e spektrit të djathtë në vende të ndryshme të botës, mbetet ende punë për të bërë përsa i përket aksesit dhe fuqizimit thelbësor të grave brenda partive. Rritja e numrit të grave në Kuvend dhe në institucione të tjera vendimmarrëse, si edhe brenda partive politike, ka sjellë një riorganizim dhe rritje të pushtetit vendimmarrës të grave, sikurse edhe të strukturave dhe lidhësive të partive, por në krahasim me partitë e majta, partitë e spektrit të djathtë kanë diferencë në përfaqësimin e grave në pozicione vendimmarrëse.

Qasja e grave në partitë e krahut të djathtë dhe më përgjithësisht në politikë, është ende plot sfida dhe kërkohen përpjekje serioze për heqjen e barrierave që hasin gratë dhe vajzat në zhvillimin e potencialit të tyre dhe karrierës politike. Nën-përfaqësimi politik i grave në partitë e spektrit të djathtë duket sikur është rrjedhojë e mungesës së një ideologjie gjinore. Për të sjellë ndryshim brenda partive të djathta, është e nevojshme të njihet rëndësia e ndërmarrjes së veprimeve pro-aktive me qëllim zhbërjen e kufizimeve institucionale partiake dhe kapërcimin e barrierave specifiku gjinore gjatë kandidimit të grave për zgjedhje në poste zyrtare.

Studimi aktual evidenton forma të ndryshme të qasjes ndaj barazisë gjinore dhe rekrutimit të grave në partitë e krahut të djathtë. Të dhënat tregojnë se sa më shumë përpjekje të bëhen për investimin tek barazia gjinore brenda partisë – duke përfshirë masat, rregulloret, strukturat dhe projektet e veçanta – aq më i madh është numri i grave dhe suksesi i partive në zgjedhje. Kështu në Mbretërinë e Bashkuar, Partia Konservatore ka ndërmarrë një rol aktiv për të siguruar që numri i grave konservatore të rritet në Dhomën e Ulët të Parlamentit Britanik, brenda partisë dhe në jetën publike duke futur: (a) masa që garantojnë procedurat e përzgjedhjes së grave kandidate, (b) struktura të veçanta brenda partisë për gratë, dhe (c) një plan strategjik për rekrutim. Advokimi strategjik i përfaqësimit të grave brenda partisë ka kontribuar në rritjen e përfaqësimit të grave deputete konservatore në Dhomën e Ulët nga 9% në mbi 20% përgjatë harkut të katër zgjedhjeve<sup>43</sup>, nga 198 vende në vitin 2005 në 365 vende në vitin 2019<sup>44</sup>, duke u bërë gjithashtu partia më e votuar në Britaninë e Madhe. Nga ana tjetër, partitë e spektrit të djathtë të cilat nuk kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm pro-aktivë për rekrutimin dhe mbështetjen e kandidateve gra, kanë përgjithësisht problem nën-përfaqësimin e grave.

Në Shqipëri, Partia Demokratike ka bërë progres të rëndësishëm për të siguruar një përfaqësim më të madh të grave në vendimmarrje në Kuvend, në nivel vendor dhe brenda strukturave partiake. Nga studimi rezulton se Partia Demokratike, ka qënë nismëtare dhe mbështetëse e disa hapave të rëndësishëm të përmirësimit të legjislacionit dhe strukturave që garantojnë barazinë gjinore në shoqëri dhe specifiku në vendimmarrje. Janë ndërmarrë hapa pozitivë për të siguruar një shkallë të caktuar të përfaqësimit të grave brenda partisë me vendosjen e kuotave të brendshme dhe organizimin vullnetar të grave, dhe gjithashtu ka një organizatë aktive dhe të strukturuar të grave brenda partisë.

<sup>43</sup>Women2win. Retrieved from: <https://www.women2win.com/about-us>

<sup>44</sup>Official Website of the UK Parliament. Retrieved from: <https://www.parliament.uk/about/how/elections-and-voting/general/previous-general-elections-in-the-uk/>



Në adresimin e çështjeve kryesore të evidentuara në këtë studim, rekomandojmë sa vijon:

### Fuqizimi i Organizatës së Grave përmes ngritjes së kapaciteteve të grave anëtare të partisë:



- ✓ Mbështetja e tyre me trajnime për fitimin e aftësive të veçanta teknike bazuar në profesionet dhe interesat e tyre, në mënyrë që të mund të kontribuojnë më mirë në politikëbërjen brenda partisë dhe në adresimin e nevojave të grave në komunitet.
- ✓ Rritja e kapaciteteve dhe investimi për zhvillimin e aftësive kërkimore, për ushqyerjen dhe sensibilizimin gjinor të politikave të partisë.
- ✓ Mbështetja e Organizatave së Grave për adresimin jo vetëm të çështjeve politike, por edhe angazhimin në aksione sociale, me qëllim forcimin e marrëdhënieve me komunitetin.

### Forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet Organizatës së Grave dhe Rinisë:



- ✓ Lehtësimi i koordinimit të aktiviteteve dhe marrëdhënieve ndërmjet Organizatës së Grave dhe Rinisë. Këto ndërlidhje mund të jenë në dobi si të kandidateve gra, ashtu edhe të kandidatëve të rinj për të vendosur marrëdhënie më të forta me bazën dhe zonat elektorale, duke fuqizuar gjithashtu zërat e tyre brenda partisë.

### Fuqizimi i Organizatës së Grave përmes:



- ✓ Krijimit të formave të qëndrueshme të mbështetjes financiare dhe mundësive për mbledhjen e fondeve, si dhe qasjes në burimet e partisë.
- ✓ Rritjes së efikasitetit të strukturës organizative dhe përmirësimit të komunikimit me anëtarësinë dhe me publikun.

### Përmirësimi i qasjes në burime dhe financime gjatë zgjedhjeve nga gratë:



- ✓ Burimet financiare janë të nevojshme për kandidimin e suksesshëm të grave zgjedhjen ënë poste. Prandaj, partitë politike duhet të marrin parasysh çështjet gjinore sa i përket financave dhe burimeve partiake. Partitë politike duhet gjithashtu të sigurojnë që kandidatët gra dhe burra të kenë qasje të barabartë në financime dhe duhet t'u vijë në ndihmë grave kandidate duke i përfshirë ato në mbledhjen e financimeve për fushatat partiake.

## Krijimi i një plani strategjik të posaçëm për gratë dhe krijimi i programeve të qëndrueshme të rekrutimit enkas për gratë profesioniste: ✓

- ✓ Krijimi i një grupi mentorimi dhe presioni brenda partisë i cili promovon zgjedhjen e më shumë grave dhe rritjen e përfshirjes së tyre në jetën publike. Investimi në programe që hapin dyert e partisë për gratë profesioniste dhe përfitojnë efektivisht nga kontributi i tyre.

## Identifikimi dhe shpërndarja e qëndrimeve të partisë për çështjet prioritare për gratë: ✓

- ✓ Futja e shqetësimeve të grave ndër prioritetet e partisë mund t'u vijë në ndihmë grave kandidate, duke ofruar një axhendë dhe duke lehtësuar arritjen më efektive të votuesve gra dhe vajza.

## Inkurajimi i grave për të përfaqësuar partinë në media: ✓

- ✓ Media tashmë është një pjesë qendrore e zhvillimit politik dhe ndërlidhjes me votuesit. Të gjitha mediat, qëllimisht apo jo, kanë prirjen për promovuar "politikën mashkullore". Më konkretisht, 90% e politikanëve të ftuar në emisionet televizive të mbrëmjes përgjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021 ishin burra, duke sjellë për pasojë që zërat e grave në politikë të dëgjoheshin më pak<sup>47</sup>. Në këtë kontekst, duhet theksuar rëndësia e përzgjedhjes dhe përgatitjes së grave për të përfaqësuar partinë në media dhe në të njëjtën kohë rëndësia e sensibilizimit të gazetarëve mbi programet dhe mbulimin mediatic profesional dhe me ndjeshmëri gjinore.

## Rritja e transparencës dhe përmirësimi i demokracisë së brendshme dhe komunikimit: ✓

- ✓ Brenda partisë, si një nga çështjet e ngritura gjatë këtij studimi, lidhen me nevojën për më shumë transparencë, informacion dhe komunikim në funksion të arritjes së një angazhimi më të mirë dhe më efektiv të grave në proceset vendimmarrëse dhe në aktivitetet partiake.

## Forcimi i bashkëpunimit me OShC-të dhe organizatat ndërkombëtare: ✓

- ✓ OShC-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive për gratë dhe vajzat. OShC-të kanë qenë partnerë strategjikë për të nxitjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit më të madh të grave dhe vajzave në partitë e spektrit të djathtë.

<sup>47</sup>Women's Network Equality in Decision Making (2021) Fair media coverage of women and men candidates in 2021 parliamentary election campaign in Albania: monitoring period during electoral campaign.

## SHTOJCA 1: Metodologjia e kërkimit

Studimi ka ndjekur një proces me tre faza: kërkim dhe vlerësim i literaturës (desk review), anketa online me gra nga partia e djathtë PD, dhe intervista/rrëfime.

Gjatë fazës së parë u ndërmor një hulumtim i thelluar i literaturës me qëllim grumbullimin e informacionit dhe praktikave më të mira në Evropë, Ballkanin Perëndimor dhe SHBA. Kjo analizë krahasuese e ndihmoi ekipin për ta njohur më mirë fenomenin, duke e lejuar atë gjithashtu të thellohet më tej në dallimet strukturore dhe ideologjike, si edhe në ndikimin gjinor të këtyre dallimeve. Hulumtimi i literaturës u fokusua në hartëzimin e partive konservatore në Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, SHBA, Shqipëri, Spanjë dhe Kroaci dhe identifikimin e të paktën 6 historive të suksesit të grave politikane të krahut të djathtë. Përpilimi i këtyre vlerësimeve gjithëpërfshirës, mbështetur edhe në një analizë të dhënave dytësore, përbën gurthemelin e vlerësimit për përsosjen e qasjes dhe fokusit në mbledhjen e të dhënave gjatë fazës së anketimit dhe intervistimit.

Gjatë fazës së dytë, anketa online pati për qëllim njohjen më mirë të pozicionit të grave në partitë e djathta në Shqipëri duke na ndihmuar të identifikojmë (a) dinamikat e brendshme të institucionit politik që përcaktojnë pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, duke njohur njëkohësisht sfidat, barrierat dhe mundësitë, si edhe (b) iniciativat formale për rekrutimin e kandidatëve potenciale femra. Anketa u realizua me gra politikane të krahut të djathtë – Deputete, ish-Anëtare të Këshillit, Kryetare Bashkie, Kryetare Këshillash dhe Anëtare partie – në nivel lokal dhe kombëtar. Kampionimi përfshinte 102 gra të spektrit të djathtë nga Partia Demokratike e Shqipërisë (PD). Anketa është projektuar dhe realizuar në mënyrë që të sigurojë të dhëna përfaqësuese kombëtare për popullsinë në fjalë, bazuar në parimin e përzgjedhjes rastësore.

Në fazën e tretë, takimet e intervistës/rrëfimit u realizuan me qëllim (a) ofrimin e një hapësire për gratë për të ndarë histori të rëndësishme për to; së dyti, (b) kuptimin e përvojave të grave nga këndvështrimi i tyre; dhe së treti, (c) zbulimin e përvojave që deri tani kanë mbetur të padukshme. Ne përdorëm kampionimin e qëllimshëm për zgjedhjen e një grupi heterogjen grash të spektrit të djathtë – Deputete, ish-Anëtare të Këshillit, Kryetare Komunash, Kryetare Këshillash dhe Anëtarë partie – duke i kushtuar vëmendje karakteristikave të tilla si mosha, përvoja politike, përkatësia etnike dhe aftësitë të kufizuara.

Duke zgjedhur dy qasje të ndryshme metodologjike – një sasiore dhe një cilësore – ne ishim në gjendje të përfitonim nga pikat e forta përkatëse të secilës qasje dhe gjithashtu të kompensojmë disa dobësitë e secilës prej tyre.

## BIBLIOGRAFIA

Duncan, P., & Busby, M. (2019, December 13). UK elects record number of female MPs | General election 2019. The Guardian. Retrieved from <https://www.theguardian.com/politics/2019/dec/13/uk-elects-record-number-of-female-mps>

Women Serving in the 117th Congress (2021-2023). (n.d.). Center for American Women and Politics. Retrieved from <https://cawp.rutgers.edu/facts/levels-office/congress/women-serving-117th-congress-2021-2023>

Grundmann, M. (2021, October 2). Opinion: The Bundestag could use more women | Opinion. DW. Retrieved from <https://www.dw.com/en/opinion-the-bundestag-could-use-more-women/a-59374736>

Congreso de los Diputados. Retrieved from: <https://www.congreso.es/busqueda-de-diputados>

Manuali Mandatet parlamentare. (2021, September 10). Kuvendi. Retrieved from <https://www.parlament.al/Files/RaporteStatistika/mandatet.pdf>

Malliga Och and Shauna L. Shames (2018) The Right Women: Republican Party Activists, Candidates, and Legislators.

Perry Bacon Jr. (2018) Why The Republican Party Elects So Few Women. FivethirtyEight. Politics. Retrieved from: <https://fivethirtyeight.com/features/why-the-republican-party-isnt-electing-more-women/>

Catherine Wineinger. (2020) How do right-wing women advocate for increased representation within parties that reject identity politics? LSE BPP. Retrieved from: <https://blogs.lse.ac.uk/politicsandpolicy/right-wing-women-as-strategic-party-actors/>

Marija Taglaga and Katrine Beauregard (2020) The Merit of Party Institutions: Women's Descriptive Representation and Conservative Parties in Australia and the United Kingdom. *Journal of Women, Politics and Policy*. Retrieved from: <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/1554477X.2020.1701934>

Rosie Campbell and Silvia Erzeel (2018). Exploring Gender Differences in Support for Rightist Parties: The Role of Party and Gender Ideology. *Political and gender*. Cambridge University Press. Retrieved from: <https://www.cambridge.org/core/journals/politics-and-gender/article/abs/exploring-gender-differences-in-support-for-rightist-parties-the-role-of-party-and-gender-ideology/E5FE0E62B60CCA02AEC2CBE28E8A9D68>

Michele Paule and Hannah Yelinl (2021) don't want to be known for it': Girls, leadership role models and the problem of representation. *European Journal of Cultural Studies*. Retrieved from: <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/13675494211004595>

Ioana M. Latu, Marianne Schmid Mast, Joris Lammers and Dario Bombari (2013) Successful female leaders empower women's behavior in leadership tasks. *Journal of Experimental Social Psychology*. Retrieved from: <https://www.ed.ac.uk/files/atoms/files/latu2013.pdf>

KPMG (2015) Women's Leadership Study: Moving Women Forward into Leadership Roles. Retrieved from: <https://assets.kpmg/content/dam/kpmg/ph/pdf/ThoughtLeadershipPublications/KPMGWomensLeadershipStudy.pdf>

Theresa May. Retrieved from: <https://www.gov.uk/government/history/past-prime-ministers/theresa-may>

Theresa May. Britannica. World leader. Retrieved from: <https://www.britannica.com/biography/Theresa-May>

Angela Merkel. Britannica. World Leaders. Retrieved from: <https://www.britannica.com/topic/Christian-Democratic-Union-political-party-Germany>

Deutschland.de (2021) Angela Merkel – her political career in pictures. Retrieved from: <https://www.deutschland.de/en/topic/politics/angela-merkel-governs-germany-16-years-as-chancellor>

Matthias Matthijs (2021) Merkel's Legacy and the Future of Germany Retrieved from: <https://www.cfr.org/in-brief/merkels-legacy-and-future-germany>

Office of the Historian, Foreign Service Institute United States Department of State. Biographies of the Secretaries of State: Condoleezza Rice (1954–) Retrieved from: <https://history.state.gov/departmenthistory/people/rice-condoleezza>

Stanford University. Condoleezza Rice. Department of Political Science. Retrieved from: <https://politicalscience.stanford.edu/people/condoleezza-rice>

TeleMadrid. Esperanza Aguirre, una vida dedicada a la política. Retrieved from: <https://www.telemadrid.es/noticias/madrid/Esperanza-Aguirre-vida-dedicada-politica-0-1392760728--20120917025137.html>

Telemadrid. La educación pública bilingüe, el logro del que Aguirre está más orgullosa. Retrieved from: <https://www.telemadrid.es/noticias/madrid/educacion-publica-bilingue-Aguirre-orgullosa-0-1392760739--20120917072859.html>

Council women World Leader. Biography: Kolinda Grabar-Kitarović. Retrieved from: <https://www.councilwomenworldleaders.org/kolinda-grabar-kitarovi263.html>

Office of the President of the Republic of Croatia. Kolinda Grabar-Kitarović. Retrieved from: <https://www.predsjednik.hr/en/bivsi-predsjednici/kolinda-grabar-kitarovic/>

Outgoing President Proud of Croatia's Achievements During Her Term Retrieved from: <https://www.total-croatia-news.com/politics/41315-outgoing-president>

NDI (2017) Political parties' internal rules from a gender perspective: Comparatives Experiences. Retrieved from: <https://nimd.org/wp-content/uploads/2017/10/Political-parties%E2%80%99-internal-rules-from-a-gender-perspective-Comparatives-Experiences-NIMD-and-IDEA.pdf>

IKNOWPOLITICS. Best Practices Used by Political Parties to Promote Women in Politics. Retrieved from: [https://iknowpolitics.org/sites/default/files/cr\\_best\\_practices\\_used\\_by\\_political\\_parties\\_to\\_promote\\_women\\_in\\_politics.pdf](https://iknowpolitics.org/sites/default/files/cr_best_practices_used_by_political_parties_to_promote_women_in_politics.pdf)

UNDP (2011) Empowering Women for stronger political parties: good practices guide promote women 'political participations Retrieved from: [https://www.ndi.org/sites/default/files/Empowering-Women-PolitParties-ENG\\_0.pdf](https://www.ndi.org/sites/default/files/Empowering-Women-PolitParties-ENG_0.pdf)

Benjamin Hohne (2022) Standing Out from the Crowd. Political Parties' Candidate (S)Election in the Transatlantic World. International Republican Institute. Retrieved from: <https://www.iri.org/resources/standing-out-from-the-crowd/>

Conservatives (2022) Code of Conduct for Members and Representatives of the Conservative Party. Retrieved from: <https://www.conservatives.com/code-of-conduct>

Conservatives. Constitution of the Conservative Party. Retrieved from: <https://public.conservatives.com/organisation-department/202101/Conservative%20Party%20Constitution%20%20as%20amended%20January%202021.pdf>

Conservative (2018) Rules for the selection of Conservative Party Candidates in Target and Conservative held seats in England, Wales and Northern Ireland for the UK Parliament. Retrieved from: <https://www.wealdenconservatives.com/sites/www.wealdenconservatives.com/files/2019-01/Rules%20for%20the%20Selection%20of%20Candidates.pdf>

Conservative (2021) Equality Opportunities policy. Retrieved from: <https://www.conservatives.com/equal-opportunities-policy>

CDU. (2022) Grundwertecharta. Antrag des Bundesvorstandes an den 35. Parteitag der CDU Deutschlands Retrieved from:

<https://assets.ctfassets.net/nwwnl7ifahow/1HEdtjRCAN8Shf1ihdkYco/bc2b167d0a79037131078d1538eb61bf/CDU-Grundwertecharta.pdf>

CDU. Änderung des Statuts und weiterer satzungrechtlicher Bestimmungen. Anträge des Bundesvorstandes an den 35. Parteitag der CDU Deutschlands. Retrieved from:

[https://assets.ctfassets.net/nwwnl7ifahow/3j2rZMoSOrjcj969avGu4X/8a0a1febee18b2bc418eac32e2777e85/B\\_Aendierungen\\_des\\_Statuts\\_der\\_GO\\_der\\_FBO\\_und\\_der\\_PGO\\_\\_Antraege\\_des\\_Bundesvorstandes\\_\\_inkl.\\_B61\\_bis\\_B63.pdf](https://assets.ctfassets.net/nwwnl7ifahow/3j2rZMoSOrjcj969avGu4X/8a0a1febee18b2bc418eac32e2777e85/B_Aendierungen_des_Statuts_der_GO_der_FBO_und_der_PGO__Antraege_des_Bundesvorstandes__inkl._B61_bis_B63.pdf)

The rules of the Republican Party: As adopted by the 2020 Republican National Convention August 24, 2020. Retrieved from:

[https://prod-static.gop.com/media/Rules\\_Of\\_The\\_Republican\\_Party.pdf?\\_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223](https://prod-static.gop.com/media/Rules_Of_The_Republican_Party.pdf?_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223)

Partido Popular. Código Etico y de Conducta. Retrieved from: [https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/codigo\\_etico\\_pdf.pdf](https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/codigo_etico_pdf.pdf)

Partido Popular. Estatutos Nacionales. Retrieved from: [https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/estatutos\\_definitivos.pdf](https://www.pp.es/sites/default/files/documentos/estatutos_definitivos.pdf)

Partido popular. Reglamentos. Retrieved from: <https://transparencia.pp.es/normativas/>

Mujeres e Igualdad. Retrieved from: [http://www.mujeresenigualdad.com/Mesa-Feminismo-Liberal\\_es\\_1\\_4142.html](http://www.mujeresenigualdad.com/Mesa-Feminismo-Liberal_es_1_4142.html)

HDZ. Zajednica žena "Katarina Zrinski". Retrieved from: <https://moj.hdz.hr/mi-smo/ustrojstvo/zajednica-zena-katarina-zrinski>

The rules of the Republican Party: As adopted by the 2020 Republican National Convention August 24, 2020. Retrieved from: [https://prod-static.gop.com/media/Rules\\_Of\\_The\\_Republican\\_Party.pdf?\\_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223](https://prod-static.gop.com/media/Rules_Of_The_Republican_Party.pdf?_ga=2.147087863.1148157337.1658054223-1561604281.1658054223)

Partia Demokratike. Lidhja e Gruas. Retrieved from: <https://pd.al/lidhja-e-gruas/>

Maggies List. Retrieved from: <http://maggieslist.org/about>

Fraue Union. Bericht zur politischen Gleichstellung von Frauen und Männern Retrieved from: <https://www.frauenunion.de/sites/www.frauenunion.de/files/artikelimages/220121-34pt-gleichstellungsbericht.pdf>

Mallig Och. (2017) assessing efforts to make the republican party more woman-friendly. Retrieved from: <https://scholars.org/contribution/assessing-efforts-make-republican-party-more-woman-friendly>

Wikipedia. Democratic Party of Albania. Retrieved from [https://en.wikipedia.org/wiki/Democratic\\_Party\\_of\\_Albania](https://en.wikipedia.org/wiki/Democratic_Party_of_Albania)

Women2win. Retrieved from: <https://www.women2win.com/about-us>  
<https://www.women2win.com/about-us>

Official Website of the UK Parliament. Retrieved from: <https://www.parliament.uk/about/how/elections-and-voting/general/previous-general-elections-in-the-uk/>

Women's Network Equality in Decision Making (2021) Fair media coverage of women and men candidates in 2021 parliamentary election campaign in Albania: monitoring period during electoral campaign.

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organ publik i Mbretërisë së Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në mbarë botën. Duke vepruar ndërkombëtarisht, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile, si dhe me zgjedhjet për të ndihmuar shtetet të kenë sisteme politike më të drejta, më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.



[www.wfd.org](http://www.wfd.org)



[@WFD\\_Democracy](https://twitter.com/WFD_Democracy)



[@WestminsterFoundation](https://www.facebook.com/WestminsterFoundation)



**WFD**

Westminster Foundation for Democracy is an executive non-departmental Public Body sponsored by the Foreign, Commonwealth & Development Office.



**UK Government**